REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

| | |
|---|---|
| Nr. 14 regjistër (JR) | Nr. 19 i vendimit |
| Datë 01.06.2020 | Datë 10.06.2022 |

# VENDIM
# NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Mimoza Tasi** | **Kryesuese** |
| **Sokol Çomo** | **Relator** |
| **Albana Shtylla** | **Anëtare** |
| **Natasha Mulaj** | **Anëtare** |
| **Rezarta Schuetz** | **Anëtare** |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 10.06.2022, ditë e premte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; dhe Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh në datën 11.05.2022, dhe në vijim në seancë gjyqësore publike në datën 01.06.2022, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe të avokatit Julian Mërtiri, të paraqitura në ankim, në parashtrimet para dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në konkluzionet përfundimtare, të cilët kërkuan përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

**1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, ishte gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar, prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

**2.** Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI"), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

*i)* *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
*ii)* *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
*iii)* *ka kryer fshehje të pasurisë;*
*iv)* *ka kryer deklarim të rremë; dhe*
*v)* *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**3.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**4.** Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim "KLGj") ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

**5.** Sipas parashikimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara përkatësisht nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe nga KLGj-ja.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

**6.** Komisioni, me vendimin nr. 184, datë 19.07.2019, vendosi: "Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]".

**7.** Në përfundim të procesit, Komisioni ka arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, por për vlerësimin e pasurisë, nuk ka arritur një nivel të besueshëm, për arsye se:

**a)** Për sa i përket banesës së ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, Komisioni ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit:

**i)** ka deklaruar saktë lidhur me aktin juridik të fitimit të truallit në rr. "{***}", Tiranë, në të cilin është ndërtuar banesa e familjes së saj;

**ii)** ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me pjesën që zotëron në këtë banesë;

**iii)** ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me sipërfaqen e ndërtimit dhe vlerën e objektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003;

**iv)** nuk arriti të provojë se personi i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme për ndërtimin e banesës në rr. "{***}", Tiranë, në shumën (-) 10.640.188 lekë.

**b)** Për sa i përket automjetit tip "Golf Volkswagen", të blerë në datën 19.03.2010, në vlerën 500.000 lekë, Komisioni ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kishin burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën (-) 152.509 lekë.

**c)** Për sa i përket automjetit tip "Mercedes Benz", të blerë në datën 20.05.2016, në vlerën 7.000 euro, Komisioni ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kishin burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën (-) 192.189 lekë.

**ç)** Për sa i përket analizës financiare të viteve 2006 - 2016, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar bilancin negativ në vlerën (-) 2.131.883 lekë.

## III. Shkaqet e ankimit

**8.** Kundër vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 02.03.2020, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, për shkaqe të lidhura me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, si dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke pretenduar se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin për faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhur me banesën e ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, për kohën e ndërtimit dhe kontributin e subjektit të rivlerësimit, dhe ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit për situatën faktike dhe mënyrën e zbatimit të ligjit lidhur me automjetet tip "Golf Volkswagen" dhe "Mercedes Benz", si dhe lidhur me analizën financiare për vitet 2006 - 2016.

**8.1.** Subjekti i rivlerësimit ankimin e shoqëroi me disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 49/2012"), subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

***a)*** *gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve;*

***b)*** *konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNj-ja, bërë në këtë procedim ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe pas gjykimit në fakt:*

***i)*** *ndryshimin e vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; dhe*

**ii)** *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

**8.2.** Shkaqet e ankimit, lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**a)** Njoftimi nga Komisioni i vendimit të arsyetuar, gjashtë muaj përtej afatit prej tridhjetë ditësh, është shkelje flagrante e ligjit që e bën procesin tërësisht të parregullt.

**b)** Komisioni duhet t'i kishte bërë me dije paraprakisht konstatimet për shkelje ligjore dhe jo nëpërmjet vendimit përfundimtar, aq më tepër nëse do të krijonte bindjen se këto konstatime mund të çonin drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**c)** Komisioni duhet t'i kishte bërë të ditura të dhënat, si personi i cili hartoi rezultatet e analizës financiare, njohuritë e posaçme që zotëronte, akti që ka hartuar, si dhe detyrat që kishte marrë, duke argumentuar se mendimi profesional i këshilltarëve ekonomikë mund të jetë përcaktues për vendimmarrjen.

**ç)** Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim parimin e proporcionalitetit, lidhur me deklarimin e më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, si një kufi ndarës për përgjegjësinë disiplinore.

**d)** Masa e shkarkimit mund të merret nëse plotësohen në mënyrë kumulative dhe jo alternative kriteret e pamjaftueshmërisë së vlerësimit të pasurive dhe të kontrollit të figurës.

**dh)** Komisioni ka shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, pasi për situata të njëjta për subjekte të tjera rivlerësimi, ka vendosur konfirmimin në detyrë dhe ka mbajtur qëndrime të ndryshme, duke mos i konsideruar si pamjaftueshmëri diferencat.

**e)** Duke iu referuar të dhënave të jetëshkrimeve të anëtarëve të trupit gjykues, të publikuara në faqen e internetit të Komisionit, subjektit të rivlerësimit i krijohet dyshimi lidhur me përmbushjen e kushteve dhe kritereve për t'u zgjedhur, përkatësisht:

**i)** për komisioneren A. F., subjekti i rivlerësimit pretendon se çdokush mund të aludojë se largimi nga detyra e rëndësishme dhe e respektuar e gjyqtares në vitin 1996, nuk është bërë me vullnetin e saj, por mund të ketë qenë pasojë e një procedimi disiplinor; dhe

**ii)** trupi gjykues i Komisionit kishte anëtarë që dukshëm ishin nën nivelin formal arsimor dhe të përvojës profesionale.

**8.3.** Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**8.3.1.** Lidhur me banesën në rr. "{***}", Tiranë, subjekti i rivlerësimit kundërshton se:

**a)** mosdeklarimi i bodrumit në deklaratën fillestare të pasurisë 2003, nuk kishte si qëllim fshehjen e pasurisë, por ishte pasojë e mungesës së informacionit për shkak të ndërtimit në mënyrë informale dhe, duke qenë ende në proces legalizimi, nuk ekzistonte juridikisht;

**b)** në kushtet e krijimit të kësaj pasurie nga bashkëshorti, para martesës, Komisioni duhet të zbatonte praktikën e tij, sipas së cilës mungesa e burimeve të ligjshme financiare për personin e lidhur, nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit;

**c)** rezultati negativ i analizës financiare lidhur me ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, prej (-) 10.640.188 lekësh, nuk është i saktë dhe në përputhje me të dhënat e administruara gjatë hetimit.

**8.3.2.** Lidhur me automjetin tip "Golf Volkswagen", subjekti i rivlerësimit kundërshton se:

**a)** është e gabuar ndarja e barabartë për çdo muaj që Komisioni u ka bërë të ardhurave vjetore të bashkëshortit, si subjekt tregtar, person fizik, për periudhën 01.01.2010 - 19.03.2010, mbi

bazën e argumentit se ato varen nga kërkesë - oferta, si dhe se Komisioni i ka llogaritur të ardhurat e bashkëshortit për vetëm dy muaj dhe jo deri në fund të kësaj periudhe; dhe

**b)** nuk janë përfshirë të ardhurat e fituara për periudhën 01.03.2010 - 19.03.2010, të llogaritura me bazë ditore.

**8.3.3.** Lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”, subjekti i rivlerësimit kundërshton se:

**a)** të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 01.01.2016 - 20.05.2016, që Komisioni i ka llogaritur në vlerën prej 699.472 lekësh, nuk mund të llogariten mbi një tarifë fikse të përmuajshme, sepse varen nga kërkesa dhe oferta; dhe

**b)** për krijimin e kësaj pasurie, ka shërbyer edhe një pjesë e të ardhurave të parapaguara nga shitja e automjetit tip “Land Rover”.

**8.3.4.** Lidhur me analizën financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për vitet 2006 – 2016, të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit kundërshton sa më poshtë.

**a)** Analiza financiare në vendim është e ndryshme nga analiza financiare pas rezultateve të hetimit.

**b)** Nuk ka asnjë informacion të qartë dhe të detajuar se si janë llogaritur shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës.

**c)** Komisioni nuk jep asnjë lloj argumenti apo shpjegimi konkret mbi mënyrën e llogaritjes së të dhënave, së analizës financiare të viteve 2009, 2011, 2012.

**ç)** Nuk ka asnjë analizë se si janë llogaritur në vite zëri *totali i likuiditeteve* dhe nuk ka gjithashtu të dhëna mbi numrat e llogarive bankare që janë marrë në analizë.

**d)** Komisioni ka pasqyruar gabim balancat e gjendjeve të depozitave/llogarive në {***} të subjektit të rivlerësimit në vitin 2009.

**dh)** Depozitat e investuara në sistemin bankar kanë qënë në monedhën euro dhe USD dhe, si rezultat i kursit të këmbimit të kohës dhe masës së depozitave bankare, konvertimi i tyre në lekë, ka rezultuar me një rivlerësim të likuiditeteve.

**e)** Për sa i përket analizës financiare të viteve 2006, 2009, 2011, 2012, 2014 dhe 2015, kundërshton se nuk ka një analizë konkrete për mënyrën e llogaritjes së të ardhurave të bashkëshortit, të shpenzimeve të udhëtimit, interesave bankarë dhe ndryshimeve në llogaritjen e kurseve të këmbimit për likuiditetet në bankë, në monedhat USD dhe euro.

## IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

*A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

*a) Juridiksioni i Kolegjit*

**9.** Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Anila Guri, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

**10.** Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis,* pasi në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore[1], në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

**11.** Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 184, datë 19.07.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

**12.** Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, me qëllim konstatimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike të çështjes në shqyrtim, vendosi gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ku në debatin gjyqësor ishte e nevojshme që subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, të jepte shpjegime lidhur me pasurinë banesë, e ndodhur në Tiranë, me pasurinë autoveturë tip "Mercedes Benz", blerë në vitin 2016, si dhe lidhur me çështje të tjera të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

**13.** Sa u takon akteve shkresore që subjekti i kishte bashkëlidhur ankimit, analiza për pranueshmërinë e tyre si prova të reja në gjykimin e çështjes, u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në këto parashikime ligjore, subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision, dhe trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se nuk ishte e nevojshme që ato të merreshin si prova *ex officio*. Në përfundim, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit dhe çështje të zbatimit të legjislacionit*

**14.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se njoftimi nga Komisioni i vendimit të arsyetuar, gjashtë muaj përtej afatit prej tridhjetë ditësh, është shkelje flagrante e ligjit që e bën procesin tërësisht të parregullt, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vendimi nr. 184, datë 19.07.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është shpallur në prezencë të subjektit të rivlerësimit në

---

[1] *Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 184, datë 19.07.2019, për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, i është njoftuar kësaj të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2020, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 18.02.2020, sipas lajmërimmarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 02.03.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {***}, datë 02.03.2020, që rezulton të jetë dita e 13-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.*

datën 19.07.2019, ndërsa i arsyetuar i është njoftuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shërbimit postar në datën 18.02.2020. Rezulton që njoftimi i vendimit të arsyetuar në adresë të subjektit të rivlerësimit, është bërë nga Komisioni në kundërshtim me parashikimet e nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, pas kalimit të afatit 30-ditor të parashikuar në këtë dispozitë.

**14.1.** Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mosrespektimi i afatit të arsyetimit të vendimit nga Komisioni nuk ka ndikuar në dhënien e vendimit të Komisionit objekt kontrolli nga Kolegji dhe, pavarësisht se ka penguar në kohë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur ankim kundër këtij vendimi, ky fakt nuk e bën vendimin e Komisionit automatikisht të cenueshëm nga Kolegji.

**15.** Lidhur me pretendimin se konstatimet e trupit gjykues të Komisionit, pas njoftimit të rezultateve të hetimit, duhet t'i ishin bërë me dije paraprakisht dhe jo nëpërmjet vendimit përfundimtar, bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[2], trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj, për arsye se qëllimi i rezultateve të hetimit nuk është të njoftojë apo t'i bëjë të ditur subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara mund të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit në çështjen konkrete, por se provat e grumbulluara kishin mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit në përfundim të fazës së hetimit administrativ.

**15.1.** Trupi gjykues vëren se, pas njoftimit nga Komisioni të rezultateve të hetimit në datën 01.07.2019, subjekti i rivlerësimit, në datën 11.07.2019, ka depozituar në Komision objeksionet lidhur me rezultatet e hetimit, së bashku me një listë dokumentesh, gjithashtu në datën 15.07.2019, nëpërmjet komunikimit elektronik, ka paraqitur objeksione dhe informacion shtesë, dhe në datën 16.07.2019, ka paraqitur kërkesën për pranimin e dokumenteve shtesë.

**15.2.** Në vijim të depozitimit të objeksioneve të subjektit të rivlerësimit në datën 11.07.2019, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 15.07.2019, trupi gjykues i Komisionit vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 17.07.2019, ora 12:00, duke arsyetuar se: "Bazuar në kërkesën e relatorit të çështjes, anëtarët e trupit gjykues nr. {***} u mblodhën për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, mbi rezultatet e hetimit dhe pas njohjes me dosjen. Relatorja e çështjes, pasi prezantoi këto shpjegime dhe prova, me të cilat anëtarët e këtij trupi gjykues janë njohur paraprakisht, u vendos që nuk ka komente apo sugjerime të mëtejshme".

**15.3.** Në kundërshtim me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konstatimet e trupit gjykues të Komisionit duhet t'i ishin bërë me dije paraprakisht dhe jo nëpërmjet vendimit përfundimtar, me qëllim për të pasur mundësinë për të paraqitur kundërshtime dhe prova shtesë mbi raportin përfundimtar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni e ka përmbushur detyrimin ligjor duke vlerësuar se provat e grumbulluara kishin nivelin e provueshmërisë, në përputhje me përcaktimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Vlerësimi paraprak, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i shërben qëllimit për të arritur në përfundimin se provat që Komisioni dispononte, kishin nivelin e provueshmërisë, por jo të prezumimit të masës disiplinore, e cila, bazuar në nenin 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendoset në përfundim të procesit.

---

[2] *Shih vendimet nr. 1/2019 (JR), nr. 2/2019 (JR), nr. 5/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR), nr. 2/2020 (JR), nr. 3/2020 (JR), nr. 6/2020 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR), nr. 22/2021 (JR), nr. 26/2021 (JR), nr. 28/2021 (JR), nr. 31/2021 (JR), nr. 3/2022 (JR) dhe nr. 5/2022 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

**15.4.** Pas kësaj faze procedurale dhe deri në fillimin e seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 55, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe nenet 20 dhe 27 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka kufizime për të paraqitur prova të reja, por, nga ana tjetër, Komisioni nuk ka detyrimin për të administruar provat e pretenduara të paraqitura rishtazi nga subjekti i rivlerësimit. Në përputhje me nenin 57, pika 4, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, Komisioni i vlerëson këto prova dhe pretendimet në tërësi, nëpërmjet vendimit përfundimtar.

**15.5.** Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i mbështetur, për sa kohë që Komisioni nuk i ka penguar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u njohur me provat që disponpremte dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit i kanë shërbyer arsyetimit të trupit gjykues të Komisionit në vendimin përfundimtar, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe të rrethanave të çështjes.

**16.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpesh mendimi profesional i këshilltarëve ekonomikë mund të jetë përcaktues për vendimmarrjen, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj për arsye se këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, bazuar në nenin 23 të ligjit nr. 84/2016, nuk gëzojnë pozitë procedurale në procesin e vendimmarrjes nga Komisioni dhe detyrat që ata kryejnë, janë në funksion të përgatitjes së çështjes nëpërmjet përgatitjes së një relacioni dhe kryerjes së detyrave të ngarkuara nga relatori i çështjes. Relacionet e këshilltarëve ekonomikë kanë natyrë këshilluese dhe, rrjedhimisht, mendimi i këshilltarëve ekonomikë nuk është përcaktues për vendimmarrjen, e cila është e drejtë dhe detyrë ekskluzive e trupit gjykues dhe, për këtë arsye, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se duhet t'i ishin bërë të ditura të dhënat e personit i cili hartoi rezultatet e analizës financiare, njohuritë e posaçme që zotëronte, akti që ka hartuar, si dhe detyrat që kishte marrë.

**17.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, referuar parimit të proporcionalitetit dhe dyfishit të pasurisë së ligjshme si kufi ndarës për efekt të masës së shkarkimit, Kolegji ka një jurisprudencë[3] të konsoliduar, nëpërmjet së cilës ka shtjelluar rëndësinë që kanë saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

**17.1.** Në analizë të interpretimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit[4], del qartë që secili prej paragrafëve të këtij neni normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, me elemente specifike dhe të pavarura, të cilat zbërthehen në përcaktimet e masave disiplinore sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ndër to, respektivisht, i pari lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme, ndërsa tjetri me pamjaftueshmërinë e deklarimit të pasurisë.

**17.2.** Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se deklarimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme është kufiri ndarës për efekt të masës së shkarkimit, nuk është i mbështetur në ligj.

**18.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se masa e shkarkimit mund të merret nëse plotësohen në mënyrë kumulative dhe jo alternaltive kriteret e pamjaftueshmërisë së vlerësimit të

[3] *Shih vendimin nr. 19/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
[4] *Shih vendimin nr. 25/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

pasurive dhe të kontrollit të figurës, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[5], trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në përcaktimin e qartë që jep Aneksi i Kushtetutës për këto dy kritere, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative.

**18.1.** Deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë përbën një zbatim të përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në nivelin e ligjit, i cili parashikon detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Nga ana tjetër, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, rregullohet në një nen të dedikuar të Aneksit të Kushtetutës, në nenin Dh. Deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, nuk mund të argumentohet se duhet të interpretohen apo vlerësohen në mënyrë kumulative. Në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, këto dy kritere nuk kërkojnë praninë e njëri-tjetrit për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm. Më tej, neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethanat faktike dhe ligjore në të cilat organet e rivlerësimit duhet automatikisht dhe pa ushtruar diskrecion, të zbatojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**18.2.** Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se masa e shkarkimit mund të vendosej në rastin e konstatimit në mënyrë kumulative të pamjaftueshmërisë së deklarimit të pasurisë dhe të figurës, nuk është i mbështetur në ligj.

**19.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se trupi gjykues i Komisionit ka shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, referuar vendimeve të dhëna për subjekte të tjera rivlerësimi, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit[6], një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike, të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni dhe, për këtë arsye, nuk është i mbështetur në ligj pretendimi i subjektit të rivlerësimit.

**20.** Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, mbi bazën e dyshimeve se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit nuk përmbushin kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur si komisionerë, përkatësisht mbi aludimin se komisionerja A.F., në vitin 1996, nuk është larguar nga detyra e gjyqtares me vullnetin e saj dhe se kishte anëtarë që dukshëm ishin nën nivelin formal arsimor dhe përvojës profesionale, trupi gjykues i Kolegjit, në përputhje edhe me përfundimin e arritur nga GjEDNj-ja në vendimin Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 300[7], vlerëson se dyshimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të arsyeshme, në kushtet kur vlerësimi i kushteve dhe kritereve për t'u zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, është realizuar nga organi kompetent[8], sipas procedurës së parashikuar në ligj.

---

[5] *Shih vendimet nr. 26/2020 (JR), nr. 1/2021 (JR) dhe nr. 25/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
[6] *Shih vendimin nr. 20/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
[7] *Në paragrafin 300 të vendimit të GjEDNj-së, Xhoxhaj kundër Shqipërisë, GjEDNj-ja, duke arsyetuar rreth kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e Komisionit pritej të përmbushnin, ka arritur në përfundimin se: "[...] këta anëtarë u përzgjodhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj [...]".*
[8] *Me vendimin nr. 82/2017, znj. A.F., z. L.H., dhe znj. S.Zh., janë zgjedhur komisionerë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.*

**20.1.** Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me cenimin e procesit të rregullt ligjor mbi bazën e argumenteve të mospërmbushjes së kushteve dhe kritereve të caktimit të anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, nuk janë të mbështetura në fakte dhe në ligj.

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

*C.1. Lidhur me banesën e ndodhur në rr. "{***}", Tiranë*

**21.** Për sa i përket mënyrës së deklarimit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e pasurisë *vetting*, rezulton e deklaruar banesa në rr. "{***}", Tiranë[9], me sip. të përafërt prej 460 m², e përbërë nga tri kate dhe një kat bodrum, e ndërtuar[10] në truallin në pronësi të bashkëshortit, z. D. G., me burim krijimi nga të ardhurat e bashkëshortit të fituara nga aktiviteti i tij tregtar pas vitit 1990 dhe puna pranë disa institucioneve, me vlerë prej 6.500.000 lekësh, përfshirë mobilimin[11], pjesa takuese 50 % me bashkëshortin.

**22.** Kolegji, pasi shqyrtoi vendimin e Komisionit, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit, lidhur me banesën e ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, vëren se Komisioni ka konstatuar këtë gjendje faktike:

**a)** *subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në këtë banesë pasi është martuar me personin e lidhur në vitin 2000, i cili e ka ndërtuar para se të fillojë bashkëjetesën me subjektin;*

**b)** *deklarimi i pjesës 50% rezulton të jetë qartësisht një deklarim i pasaktë, i bërë nga subjekti, duke marrë në konsideratë faktin se konsiderohet si pasuri bashkëshortore, në bazë të nenit 74 të Kodit të Familjes, dhe jo një pasuri e cila duhet të konsiderohet e përbashkët në kuptim të kontributit të dhënë nga të dy subjektet;*

**c)** *nuk rezultoi e provuar se subjekti ka kontribuuar në ndërtimin e saj para momentit të lidhjes së martesës; dhe*

**ç)** *duke qenë se kjo banesë ende nuk është e regjistruar, nuk ka një akt juridik që të përcaktojë pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit, me qëllim analizën e tyre.*

**22.1.** Pavarësisht këtyre konstatimeve, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se personi i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme për ndërtimin e banesës.

**23.** Në deklaratën e pasurisë *vetting,* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është "[...] e përbërë nga tri kate dhe një kat bodrum, me sipërfaqe banimi rreth 460 $m^2$ [...] aktualisht në proces legalizimi [...]", ndërsa në deklaratën e pasurisë 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "[...] tokë truall, banesë 2k + papafingo [...]". Sipas vetëdeklarimit për legalizim objekti nr. {***} prot., datë 07.11.2006, sipërfaqja e ndërtimit është deklaruar 170 $m^2$, e përbërë nga 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë[12].

---

*[9] Ish-rruga "{***}", Tiranë.*

*[10] Ndërtimi i së cilës sipas deklaratës së pasurisë vetting, kishte filluar në vitin 1998 dhe ishte në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, Tirana Jug.*

*[11] Për mobilimin e së cilës, sipas deklaratës e pasurisë vetting, ka kontribuar edhe subjekti i rivlerësimit.*

*[12] Shkresa nr. {***} prot., datë 13.01.2017, e ALUIZNI-t Tiranë Jug, nr. {***}, f. {***} e dosjes së ILDKPKI-së, dhe shkresa nr. {***} prot., datë 29.08.2017 e ALUIZNI-t Tiranë Jug, në nr. {***}, f. {***} e dosjes së ILDKPKI-së.*

**23.1.** Trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se përkon deklarimi i kateve mbi tokë në deklaratën e pasurisë *vetting* me deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, por në atë deklaratë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar katin nën tokë (bodrumin). Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se fakti që banesa ka qenë në proces legalizimi, nuk ka qenë pengues për subjektin e rivlerësimit që të deklaronte saktësisht këtë pasuri.

**23.2.** Ballafaqimi i deklarimeve të pasurisë periodike/vjetore me ato të bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë në deklaratën *vetting*, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj.

**23.3.** Pavarësisht pasaktësisë lidhur me sipërfaqen e ndërtimit të konstatuar nga Komisioni në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të barazohet me pasaktësinë e plotësimit të deklaratës *vetting* dhe, si pasojë, ajo nuk mund të justifikohet si një shkak i ligjshëm për dhenien e masës displinore të shkarkimit.

**24.** Për sa i përket justifikimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka arritur në konkluzionin se ndërtimi i banesës në rr. "{***}", Tiranë, në truallin e blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit[13], z. D. G., ka filluar në vitin 1998[14] dhe punimet kanë vijuar edhe në vitin 1999, përpara lidhjes së martesës dhe fillimit të bashkëjetesës të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit në datën 10.10.2000[15], dhe është krijuar me burime financiare të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ka kontribuuar në ndërtimin e saj para momentit të lidhjes së martesës dhe fillimit të bashkëjetesës.

**24.1.** Në këto rrethana, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme[16], Kolegji çmon se periudha në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka investuar për ndërtimin e banesës në rr. "{***}", ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit ishin në kushtet e bashkësisë ligjore, dhe kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur vepronin financiarisht në autonomi të plotë.

**24.2.** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur që kanë shërbyer si burime për ndërtimin e banesës në rr. "{***}", Tiranë, nga hetimi administrativ në Komision, nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dijenisë dhe të pranimit të faktit që ka pranuar të përdorë një banesë për të cilën ka ditur se është krijuar nga të ardhura me burime të kundërligjshme, situatë kjo që do e bënte të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit.

**25.** Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të situatës së mësipërme faktike, çmon se problematikat e konstatuara lidhur me pasurinë banesë në rr. "{***}", Tiranë, nuk janë të

---

[13] *Nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.11.1998.*
[14] *Sipas formularit të vetëdeklarimit nr. {***}, datë 07.11.2006, të ALUIZNI-t.*
[15] *Sipas certifikatës së martesës nr. akti {***}, dat 03.05.2019, të Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake Nr. {***}, Tiranë.*
[16] *Shih vendimin nr. 15/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

*C.2. Lidhur me automjetin tip "Golf Volkswagen"*

**26.** Për sa i përket mënyrës së deklarimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip "Golf Volkswagen", viti i prodhimit 2000, me burim krijimi: "[...] të ardhurat e krijuara nga puna [...]" e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, të blerë nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2010, në vlerën prej 500.000 lekësh, pjesa takuese 50%, me bashkëshortin.

**26.1.** Në deklaratën e pasurisë periodike/vjetore 2010, ka deklaruar: "[...] blerë automjeti me kontratën, datë 19.03.2010, nr. {***} rep., nr. {***} kol. [...][17], që e ballafaquar me kontratën e shitjes, rezulton që deklarimi i subjektit të rivlerësimit të jetë i saktë.

**26.2.** Gjithashtu, në deklaratën e pasurisë periodike/vjetore 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "[...] të ardhurat nga puna e bashkëshortit si avokat [...]", në shumën prej 900.000 lekësh, ndërkohë që Komisioni për periudhën 01.01.2010 - 19.03.2010, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i ka njohur të ardhura në shumën prej 192.000 lekësh, duke "[...] bërë një ndarje në mënyrë të barabartë të fitimit në çdo muaj të vitit".

**26.3.** Komisionit i rezultoi se deklarimi ishte i saktë, por se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kishin mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në shumën prej (-) 152.509 lekësh.

**26.4.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në mënyrë të gabuar, Komisioni ka arritur në përfundimin se: "Lidhur me pretendimin e realizimit të të ardhurave nga vetëpunësimi i bashkëshortit në shumën 1.152.000 lekë, Komisioni çmon se ato kanë mbetur në nivel deklarativ, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova bindëse për sa ka pretenduar", sepse trupit gjykues të Kolegjit, nga shkresa nr. {***} prot., datë 17.02.2019, e DRTT-së, fitimi pas tatimit i bashkëshortit, i regjistruar si person fizik, i rezulton të ketë qenë në shumën prej 1.152.000 lekësh.

**26.5.** Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit, për blerjen e automjetit tip "Golf Volkswagen", trupit gjykues të Kolegjit i rezultuan sa më poshtë.

**26.6.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se është e gabuar ndarja e barabartë për çdo muaj e të ardhurave vjetore të bashkëshortit nga aktiviteti privat në vitin 2010, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, *së pari* nuk ka deklaruar një vlerë të përcaktuar dhe *së dyti*, llogaritjen e të ardhurave që përkojnë me periudhën e blerjes së autoveturës, vetë subjekti i rivlerësimit e ka kryer po në mënyrë të barabartë për çdo muaj, sikurse dhe Komisioni, dhe për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pambështetur këtë pretendim.

**26.7.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka llogaritur të ardhurat për periudhën 01.03.2010 - 19.03.2010, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim është i mbështetur, për arsye se të ardhurat e bashkëshortit për këtë periudhë, Komisioni i ka

[17] *Kontrata shitblerje autoveture nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2010.*

llogaritur në vlerën prej 192.000 lekësh[18], që përkon me ndarjen e barbartë të të ardhurave totale prej 1.152.000 lekësh të bashkëshortit për dy muaj, pa përfshirë periudhën në llogaritje të të ardhurave deri në datën 19.03.2010.

**26.8.** Në këto kushte, në funksion të një analize garantiste dhe shteruese, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në të ardhurat e periudhës 01.03.2010 - 19.03.2010, duhet të përfshihet edhe vlera prej 57.600 lekësh[19]. Për të bërë një analizë të plotë, trupi gjykues i Kolegjit, duke aplikuar të njëjtin standard edhe për shpenzimet e jetesës për katër persona[20] për periudhën 01.03.2010 - 19.03.2010, korrigjon edhe shpenzimet e jetesës në vlerën prej 27.324 lekësh[21].

**26.9.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në analizën financiare për periudhën 01.01.2010 - 19.03.2010, Komisioni nuk ka konsideruar shtesat/pakësimet e likuiditeteve në bankë të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe dy djemve, të cilat në krahasim me balancën në datën 31.12.2009, rezultonin të pakësuara në shumën e ekuivalentuar prej 1.751.688 lekësh[22], bazuar në faktin se vlera e likuiditeteve në bankë në datën 19.03.2010, rezulton të kenë qenë 1.334.199 lekë[23].

**26.10.** Duke konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit për periudhën 01.01.2010 – 19.03.2010, shpenzimet e jetesës për periudhën 01.01.2010 – 19.03.2010[24], të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave, si dhe shtesat/pakësimet e likuiditeteve në bankë, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur gjendeshin me tepricë burimesh të ligjshme prej (+) 1.708.313 lekësh[25].

**26.11.** Për këto arsye, lidhur me automjetin tip “Golf Volkswagen”, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e tij në vitin 2010 dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*C.3. Lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”*

**27.** Për sa i përket mënyrës së deklarimit, trupi gjykues vëren se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 2006, me burim krijimi *të ardhurat nga puna* e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, blerë nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.2016, në vlerën prej 7.000 eurosh, pjesa takuese 50%, me bashkëshortin.

---

[18] *Referuar fitimit të vitit 2010, prej 1.152.000 lekësh / 12 muaj = 96.000 lekë në muaj x 2 muaj = 192.000 lekë.*

[19] *Përkatësisht: 1.152.000 lekë në vit : 12 muaj = 96.000 lekë/muaj : 30 ditë = 3.200 lekë/ditë x 18 ditë = 57.600 lekë.*

[20] *Në përputhje me vlerat e aplikuara nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat statistikore të INSTAT-it.*

[21] *Përkatësisht: 546.480 lekë në vit : 12 muaj = 45.540 lekë/muaj : 30 ditë = 1.518 lekë/ ditë x 18 ditë = 27.324 lekë.*

[22] *Përkatësisht në datën 19.03.2010: llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit në {***}, kishte balancën prej 160.843 lekësh dhe depozitat e investuara në fund të vitit 2009, ishin në shumën prej 1.000.000 lekësh dhe 442.250 lekësh, të cilat pas maturimit në datën 07.01.2010, u tërhoqën cash nga subjekti i rivlerësimit (në vlerën prej 1.586.500 lekësh); llogaria e bashkëshortit në {***} në lekë, kishte balancë prej 6.426,67 lekësh, pra ishte shtuar; llogaria e të birit, z. K. G., në {***} në lekë, kishte balancë prej 65.242,5 lekësh, pra ishte shtuar; llogaria e të birit, z. K. G., në {***} në lekë, kishte balancën prej 35.116,74 lekësh, pra ishte shtuar; depozita në euro në {***} e subjektit të rivlerësimit, shuma prej 4.378 eurosh, tërhequr cash nga subjekti i rivlerësimit; depozita në USD në {***} e subjektit të rivlerësimit, kishte balancë prej 10.640 USD, pra ishte shtuar.*

[24] *Në total, prej 118.404 lekësh.*

[25] *Si rezultat (a) i të ardhurave në total, prej 595.851 lekësh, zbritur (b) shpenzimet në total prej 139.226 lekësh, zbritur (c) pasuri në total, prej – 1.251.688 lekësh (si total i vlerës së automjetit prej 500.000 lekësh dhe pakësimit të likuiditeteve në bankë prej – 1.751.688 lekësh).*

**27.1.** Në deklaratën e pasurisë periodike/vjetore 2016, subjekti i rivlerësimit, pa referim në burimin e krijimit, ka deklaruar blerjen e automjetit, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.2016, në çmimin prej 7.000 eurosh[26]: "[...] likuidimi kesh në dorë jashtë zyrës noteriale [...]", që e ballafaquar me këtë kontratë, rezulton që deklarimi i subjektit të rivlerësimit të jetë i saktë. Gjithashtu në deklaratën periodike/vjetore, lidhur me të ardhurat vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "Të ardhura nga puna e bashkëshortit si avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, 1.678.932 lekë".

**27.2.** Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte kryer deklarim të saktë të kësaj pasurie, por se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kishin mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në shumën prej (-) 192.189 lekësh.

**27.3.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit, rezulton se trupi gjykues i Komisionit, zërin "të ardhura nga punësimi, bashkëshorti, periudha 1.1.2016 - 20.5.2016", e ka llogaritur në shumën prej 699.472 lekësh, pa arsyetuar në lidhje me mënyrën e përllogaritjes së kësaj shume, por sikurse edhe subjekti i rivlerësimit argumenton në objeksione kundër rezultateve të hetimit, nga trupi gjykues i Komisionit rezulton se edhe për këtë pasuri, është përdorur metodologjia e ndarjes së barabartë në çdo muaj e të ardhurave të bashkëshortit, person fizik, në vitin 2016[27].

**27.4.** Lidhur me pretendimin e paraqitur për herë të parë në pyetësorin nr. {***}, se për blerjen e automjetit "Mercedes Benz", janë përdorur edhe të ardhurat nga shitja e automjetit "Land Rover", në vijim, trupi gjykues i Kolegjit ka marrë në shqyrtim dokumentet mbi të cilat ky pretendim bazohet, përkatësisht: a) aktmarrëveshja, datë 19.05.2016; b) kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2016; dhe c) deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2020.

**27.5.** Nga aktmarrëveshja, datë 19.05.2016[28], ndërmjet shitësit D. G. dhe blerësit E. S., rezulton se shitësi ka: "[...] marrë shumën prej 6.500 (gjashtë mijë e peseëqind) eurosh në formë kapari për shitjen, shtetasit E. S., të mjetit në pronësi [...] "Land Rover" [...]{***} [...]", dhe se: "blerësi, z. E. S., brenda gjashtë muajve [...] do të paguajë diferencën e çmimit, në të kundërt z. D. G. është i lirë të shesë këtë mjet te çdo i interesuar, duke i kthyer shumën e marrë, prej 6.500 eurosh [...]", dhe se: "[...] palët do të nënshkruajnë kontratën e pronësisë së mjetit në momentin që z. E. S. do të paguajë diferencën e vlerës prej 2.000 (dy mijë) eurosh".

**27.6.** Nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2016, ndërmjet shitësit D. G. dhe blerësit E. S., e cila është depozituar edhe së bashku me ankimin, për shitjen e automjetit "Land Rover", me targë {***}, rezulton se shitësi: "[...] me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, ia shet automjetin [...] blerësit kundrejt çmimit prej 8.500 eurosh. Shitësi deklaroi përpara [...] noterit se pagesa është kryer tërësisht jashtë kësaj zyre [...]".

---

[26] *Kontratë shitblerjeje autoveture nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.2016, nr. {***}, f. {***}, dosja e ILDKPKI-së.*

[27] *Shprehimisht, në objeksionet kundër rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "Nëse është përdorur metoda e përdorur si dhe për pasurinë autoveturë tip "Golf Volkswagen", kam të njëjtin argument".*

[28] *Shkresë e thjeshtë e nënshkruar nga deklaruesit, z. D. G.dhe z. E. S., në prezencë të z. B. N..*

**27.7.** Trupit gjykues të Kolegjit, nga përmbajtja e kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2016, nuk i rezultojnë të dhëna që të dëshmojnë pagimin e çmimit edhe nëpërmjet aktmarrëveshjes për kaparin.

**27.8.** Në deklaratën e pasurisë periodike/vjetore 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "Të ardhura nga shitja e automjetit tip "Land Rover", fuoristradë, sipas kontratës së shitjes, datë 14.09.2016, me nr. {***} rep., nr. {***} kol.", në shumën prej 8.500 eurosh, duke mos referuar aktmarrëveshjen për kaparin.

**27.9.** Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2020[29], të paraqitur së bashku me ankimin: "[...] në kohën që z. D. G. donte të më shiste mjetin, i kam dhënë fillimisht shumën që kisha, prej 6.500 eurosh, dhe i mbeta një pjesë të vogël, të cilën për arsye personale e sigurova më vonë. Më pas kemi lidhur kontratën te noteri".

**27.10.** Nga shqyrtimi në tërësi i deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaratën e pasurisë periodike/vjetore 2016, aktmarrëveshjen, datë 19.05.2016, kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2016, dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2020, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ato nuk janë të harmonizuara me njëra-tjetrën, për sa i përket mënyrës së kryerjes së pagesës dhe, si pasojë, e konsideron të paprovuar këtë pretendim të subjektit të rivlersimit.

**27.11.** Në këto kushte, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton e provuar se nga shitja e automjetit tip "Land Rover", është përfituar shuma totale prej 8.500 eurosh, por e paprovuar bindshëm koha e pagesës, ndërsa pretendimi i disponimit të kësaj të ardhure për blerjen e automjetit tip "Mercedes Benz", bie ndesh me deklaratën e pasurisë *vetting,* e cila nuk e paraqet si burim të ardhurën nga çmimi i shitjes së automjetit "Land Rover", por vetëm të ardhurat nga puna.

**27.12.** Për sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2020, të z. E. S., bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[30], në përmbajtje ajo ka vlerë të kufizuar provuese.

**27.13.** Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, brenda shkaqeve të ankimit, për blerjen e automjetit tip "Mercedes Benz", trupit gjykues të Kolegjit i rezultuan sa trajtohet më poshtë.

**27.14.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se është e gabuar ndarja e barabartë për çdo muaj e të ardhurave vjetore të bashkëshortit nga aktiviteti privat në vitin 2016, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, *së pari,* nuk ka deklaruar një vlerë të përcaktuar dhe, *së dyti,* llogaritjen e të ardhurave që përkojnë me periudhën e blerjes së autoveturës, vetë subjekti i rivlerësimit e ka kryer po në mënyrë të barabartë për çdo muaj, sikurse dhe Komisioni, dhe për këtë arsye trupi, gjykues i Kolegjit e gjen të pambështetur këtë pretendim.

**27.15.** Në këto kushte, trupit gjykues të Kolegjit, sikurse dhe Komisionit, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit për periudhën 01.01.2016 - 20.05.2016, i rezultojnë në shumën prej 699.472 lekësh[31] dhe, si pasojë, është i drejtë konkluzioni i Komisionit për mungesën e justifikimit të burimeve të ligjshme të të ardhurave në shumën (-) 192.189 lekë.

---

*[29] Bashkëlidhur edhe kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2016.*
*[30] Shih vendimet nr. 23/2020 (JR), nr. 34/2019(JR), nr. 3/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
*[31] Përkatësisht: 1.678.732 lekë / 12 muaj x 5 muaj = 699.472 lekë, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 27.02.2019, të DRT-së.*

**27.16.** Trupi gjykues i Kolegjit, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për të justifikuar blerjen e automjetit "Mercedes Benz", si e vetme, është jodomethënëse për vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, dhe nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi[32].

**28.** Për këto arsye, lidhur me automjetin tip "Mercedes Benz", trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk justifikojnë me burime financiare të ligjshme, blerjen e tij në vitin 2016, në shumën (-) 192.189 lekë, por e konsideron këtë vlerë të pamjaftueshme për të konsideruar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

*C.4. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2006 - 2016*

**29.** Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit për periudhën 2006 - 2016, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se:

**29.1.** Për sa i përket pretendimit se analiza financiare në vendim është e ndryshme nga analiza financiare pas rezultateve të hetimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i mbështetur në aktet e çështjes dhe ndryshimet konsistojnë në:

**a)** uljen e shpenzimeve të jetesës për vitet 2006 dhe 2007[33], pas pretendimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve hetimore, përkatësisht:
  - **i)** për vitin 2006, rezultojnë të ulura shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit dhe djalin që lindi në ShBA, për periudhën e qëndrimit në ShBA, prej 2,5 muajsh, sipas pretendimeve të subjektitit të rivlerësimit[34];
  - **ii)** për vitin 2007, rezultojnë të ulura shpenzimet e jetesës për familjen, duke i llogaritur si mesatare e ponderuar të shpenzimeve të jetesës së familjes të vitit 2007 dhe vitit 2008[35];

**b)** konsiderimin në të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit për vitin 2007[36], të vlerës prej 225.450 lekësh[37];

**c)** uljen e shpenzimeve të udhëtimit për vitet 2007 dhe 2011[38], përkatësisht:

---

[32] *Shih vendimet nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

[33] *Përkatësisht ulje të tyre, në vitin 2006, nga 438.228 lekë në 401.761 lekë dhe në vitin 2007, nga 943.872 lekë në 745.176 lekë.*

[34] *Shih poshtëshënimin nr. 33 në vendimin nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përkatësisht: "33 Subjekti pretendoi pas dërgimit të rezultateve të hetimit që t'i zbriten shpenzimet e jetesës në Shqipëri për periudhën gjatë së cilës ka qëndruar në shtetin amerikan. Trupi gjykues çmoi që ta marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe u zbritën shpenzimet e jetesës në Shqipëri për një periudhë prej 2,5 muajsh për subjektin dhe djalin e saj, periudhë gjatë të cilës kanë jetuar në ShBA. Shpenzimet e jetesës për këtë vit, në Shqipëri, janë konsideruar në shumën 401.761 lekë".*

[35] *Shih poshtëshënimin nr. 55 në vendimin nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përkatësisht: "55. Shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë llogaritur si mesatare e ponderuar e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007 (shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë 943.872) dhe vitin 2008 (shpenzimet e jetesës për vitin 2008 janë 546.480 lekë) dhe janë marrë 745.176 lekë/vit shpenzimet e jetesës për vitin 2007, dhe jo sa i ka vënë ILDKPKI-ja".*

[36] *Duke konsideruar shumën 225.450 lekë, nga 0 që ishte në analizën financiare në raportin e rezultateve hetimore.*

[37] *Shih poshtëshënimin nr. 54 dhe në paragrafët 4 dhe 5 në vendimin nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

[38] *Përkatësisht ulje të tyre, në vitin 2007, nga 380.867 lekë në 253.911 lekë dhe në vitin 2011, nga 470.220 lekë në 381.708 lekë.*

i) për vitin 2007, pavarësisht se në vendim nuk jepet informacion se çfarë është konsideruar nga Komisioni në rishikimin e analizës, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve hetimore ka evidentuar se ka kryer dy udhëtime, në datat 08.10.2007 - 12.10.2007 në Gjermani[39], dhe në datat 12.11.2007 - 16.11.2007 në Rumani[40], për të cilat shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe qëndrimit janë mbuluar nga organizatorët, kjo ulje duket në koherencë me pretendimet e subjektit të rivlerësimit;

ii) për vitin 2011, rezultojnë të ulura shpenzimet e udhëtimit[41];

ç) për vitin 2006, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve hetimore, është rishikuar vlera prej 442.936 lekësh e shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit në shtetin amerikan[42];

d) për vitin 2014[43], sipas pretendimeve të subjektit, në përgjigje të rezultateve hetimore, rezultojnë të rritura përllogaritjet e likuiditeteve në fund të vitit 2014, në vlerën 1.040.000 lekë[44], përkatësisht:

i) gjendja e likuiditeteve në bankë është dhënë e detajuar në formë tabele në f. 19 të raportit të rezultateve hetimore, poshtë tabelës së analizës financiare të viteve 2006 - 2016 dhe në f. 27 të vendimit, si dhe pas rishikimit të analizës financiare në vendim në f. 30 – 31, në vijim të tabelës së analizës financiare të viteve 2006 – 2016, të rishikuar pas përgjigjeve të rezultateve hetimore; dhe

ii) me ndryshimin e gjendjes së likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2014, ka ardhur si pasojë dhe ndryshimi i zërit “Shtesa/pakësime, likuiditete *cash* dhe bankë” në tabelën e analizës financiare të viteve 2006 - 2016 të rishikuar[45], për vitin 2014, duke u bërë 1.306.358 lekë [nga 266.358 lekë që ishte në analizën financiare në rezultatet hetimore] dhe për vitin 2015, duke u bërë 862.931 lekë [nga 1.902.930 lekë që ishte në analizën financiare në rezultatet hetimore].

**29.2.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk ka asnjë informacion të qartë dhe të detajuar se si janë llogaritur shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i pambështetur për sa më poshtë.

---

[39] *Subjekti shpjegon se “[...] kam udhëtuar për në Gjermani, ku kam marrë pjesë në seminarin mbi “Trajtimi i azilkëruesve dhe i emigrantëve”, i organizuar nga Academy of European Law Trier (ERA), dhe të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe qëndrimit në {***},Gjermani, u mbuluan nga organizatorët. Ju lutem shikoni certifikatën e pjesëmarrjes, si dhe informacionin në adresën në internet: https://www.era.int/cgi-bin/cms?_SID=NEW&_sprache=en&_bereich=ansicht&_aktion=detail&schluessel=era, lidhur me atë çfarë organizatorët përfaqësojnë, pasi unë nuk disponoj ndonjë dokument lidhur me këtë fakt, për shkak edhe të kohës së gjatë që ka kaluar”. Certifikatë, te dosja profesionale, faqe 58.*

[40] *Shih poshtëshënimin nr.56 në vendimin nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

[41] *“56 Komisioni i analizon shpenzimet gjatë udhëtimit dhe periudhës së qëndrimit jashtë, duke përllogaritur normën 10 euro/ditë. Lidhur me këto udhëtime që subjekti i rivlerësimit pretendoi se bashkëshorti i saj ka qëndruar tek i vëllai, që banon në {***}, ka vënë në dispozicion të Komisionit një kontratë qiraje që vërteton se vëllai i tij jeton në {***}. Për 3 udhëtime të bashkëshortit të subjektit në vitin 2011, me destinacion {***}, trupi gjykues çmoi që shpenzimet e qëndrimit gjatë këtyre udhëtimeve në këtë destinacion, të llogariten me 10 euro/ditë”.*

[42] *Shih poshtëshënimet nr. 34 dhe nr. 36 në vendim nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

[43] *Përkatësisht rritje nga totali prej 6.529.319 lekësh në 7.569.319 lekë.*

[44] *Shih dy paragrafët e fundit në faqen 29 në vendimin nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

[45] *Shih f. 30 të vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

a) Shpenzimet e jetesës, Komisioni i ka konsiderur në përputhje me standardet e aplikuara nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat statistikore të INSTAT-it, të cilat i janë bërë të njohura subjektit të rivlerësimit, përkatësisht:
   i) në raportin e rezultateve hetimore, Komisioni u referohet[46] akteve të administruara në Komision gjatë hetimit dhe shprehet për to;
   ii) në vendim gjithashtu Komisioni ka referuar[47] se ku është mbështetur për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës[48];
   iii) subjektit të rivlerësimit i janë vënë në dispozicion aktet e dërguara Komisionit[49] nga ILDKPKI-ja, lidhur me shpenzimet e jetesës[50]; dhe
   iv) gjithashtu pas përgjigjeve të rezultateve hetimore nga subjekti, me rishikimin e analizës financiare, Komisioni në vendim, ka shpjeguar dhe ndryshimin e shpenzimeve të jetesës në krahasim me analizën financiare në raportin e rezultateve hetimore[51].
b) Për shpenzimet e udhëtimit, Komisioni ka referuar në raportin e rezultateve hetimore dhe në vendim se i është referuar sistemit TIMS, nuk ka shpjeguar përllogaritjet e kryera për vitet e analizuara, por ka dhënë shpjegime vetëm në rastet kur me rishikimin e analizës financiare pas përgjigjeve të rezultateve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, ka rishikuar shpenzimet e udhëtimit, përkatësisht:
   i) në vendim, Komisioni është shprehur se ka konsideruar shpenzime qëndrimi prej 10 USD/ditë për qëndrimin e subjektit në ShBA në vitin 2006, sipas poshtëshënimit nr. 36, f. 21, për të cilin ka pretenduar se ka qëndruar te xhaxhai i bashkëshortit dhe për shpenzimet e qëndrimit prej 10 eurosh/ditë për qëndrimin e bashkëshortit të subjektit në vitin 2011, për të cilin ka pretenduar se ka qëndruar te vëllai i tij në Itali, sipas poshtëshënimit nr. 56, f. 28; dhe
   ii) sipas objeksioneve shtesë lidhur me shpenzimet për udhëtimet, të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në datën 15.07.2019[52], rezulton se është njohur me të dhënat mbi metodikën e përdorur nga Komisioni në analizën financiare, në raportin e rezultateve hetimore[53].

---

[46] *Poshtëshënimi nr. 18, f. 10, poshtë analizës së kryer për pasurinë automjet "Golf Wolkswagen" blerë në vitin 2010, poshtëshënimi nr. 24, në f. 12, poshtë analizës së kryer për pasurinë automjet "Mercedes Benz", blerë në vitin 2016, dhe poshtëshënimi nr. 53, i fundit i listuar, në faqen 28 të vendimit të Komisionit. Si dhe, citim "Kërkesë nr. {***} prot., dt, 15.2.2019, drejtuar ILDKPKI-së, mbi kostot e jetesës; ILDKPKI-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot. dt 21.2.2019".*

[47] *Poshtëshënimi nr. 15, f. 12, poshtë analizës së kryer për pasurinë automjet "Golf Wolkswagen", blerë në vitin 2010, poshtëshënimi nr. 21, f. 14, poshtë analizës së kryer për pasurinë automjet "Mercedes Benz", blerë në vitin 2016, në vendimin e Komisionit.*

[48] *Citim: "Shpenzimet e jetesës nga ILDKPKI-ja, e cila bazohet në INSTAT".*

[49] *Aktet me nr. {***}prot., me të Komisionit, datë 21.02.2019 dhe gjithashtu me nr. {***} prot., me të Komisionit, datë 4.03.2019.*

[50] *Referuar deklaratës së subjektit të rivlerësimit, datë 10.07.2019, për njohjen e dokumentacionit fizik dhe në formë CD-je, sipas listimit në inventarin përkatës.*

[51] *Poshtëshënimi nr. 33, f. 21, në analizën e kryer për vitin 2006 dhe sipas poshtëshënimit nr. 55, f. 28, në analizën e vitit 2007 të vendimit të Komisionit.*

[52] *Protokolluar në Komision, me nr. {***} prot., datë 18.07.2019.*

[53] *Të cilat konsistojnë në: <u>a)</u> me avion, sipas informacionit në objeksionet e subjektit, se për low cost, janë konsideruar 175 euro dhe 330 euro për udhëtime më të gjata – ka vlerësuar se për udhëtimet e bashkëshortit të saj, në 2011 – 2015, në {***} – Itali, me linja direkte, low cost, çmimi i biletës ka qenë më i ulët ose rreth 118 - 138 euro; <u>b)</u> për udhëtimet drejt Kosovës dhe Malit të Zi që kanë qenë me kthim brenda ditës për disa orë, subjekti ka pretenduar se nuk duhet të llogariten me 50 euro [ose 4 persona x 50 euro = 200 euro], duke e konsideruar si të lartë këtë shpenzim, duke pasur parasysh që familja nuk ka pasur shpenzime akomodimi dhe mund të ketë konsumuar vetëm një vakt; <u>c)</u>*

**29.3.** Për sa i përket pretendimit se në vendim, Komisioni nuk jep asnjë lloj argumenti apo shpjegimi konkret mbi mënyrën e llogaritjes për analizën financiare të viteve 2009, 2011, 2012, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendimin nuk është i mbështetur në prova.

**29.3.1.** Pavarësisht se në të dhënat e paraqitura në tabelën në f. 27 të vendimit, Komisioni nuk ka shpjeguar në mënyrë eksplicite vlerat e konsideruara në analizë të viteve, për të ardhurat, pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, në raportin e rezultateve hetimore, Komisioni ka renditur *deklarimin e të ardhurave*, në f. 27, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe, në vijim, të dhënat sipas hetimit në Komision, ku janë përfshirë në analizën e viteve të ardhurat nga punësimi, interesat bankarë dhe të ardhurat e tjera të deklaruara ndër vite e të provuara me akte nga subjekti apo nga hetimi i kryer. Për sa u përket *pasurive*, ato rezultojnë të konsideruara në vijimësi të deklarimeve të subjektit ndër vite dhe sipas akteve përkatëse. Për sa u përket likuiditeteve, ato janë konsideruar sipas nxjerrjeve të llogarive bankare, në reference të korespondencave të Komisionit me institucionet financiare. Për sa u përket *shpenzimeve të jetesës*, Komisioni ka referuar në të dhënat e ILDKPKI-së, sipas INSTAT-it. Gjithashtu, sipas objeksioneve shtesë të subjektit të rivlerësimit në datën 15.07.2019[54], të dërguara me *e-mail*, rezulton se është njohur me të dhënat mbi metodikën e përdorur nga Komisioni në analizën financiare në raportin e rezultateve hetimore dhe me tabelat në programin *Excel* lidhur me analizën financiare.

**29.4.** Për sa i përket pretendimit se në vendim nuk ka asnjë analizë se si janë llogaritur në vite zëri *Totali i likuiditeteve* dhe nuk ka gjithashtu të dhëna mbi numrat e llogarive bankare që janë marrë në analizë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur për sa trajtuar më poshtë.

**29.4.1.** Në raportin e rezultateve të hetimit për vitet 2006 - 2016, rezulton tabela e emërtuar "Në vijim një kronologji e llogarive bankare nga viti 2003 - 2016". Po ashtu, në vendim, pas rishikimit të analizës financiare në vijim të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit pas rezultateve të hetimit, rezulton tabela e analizës financiare e rishikuar për vitet 2006 - 2016, në f. 30 – 31, e emërtuar "Likuiditete në bankë sipas viteve", me të njëjtat përmbajtje si ajo në raportin e rezultateve hetimore, por me ndryshimin e vetëm të përfshirjes së balancës në fund të vitit 2014, se ka vazhduar të ketë gjendje dhe vlerën 1.040.000 lekë në Bankën e Shqipërisë, në emër të znj. Anila Guri, siç ka shpjeguar Komisioni në dy paragrafët e fundit (në faqen 29 të vendimit). Kjo, si pasojë, ka sjellë dhe ndryshim në tabelën e analizës financiare të viteve 2006 – 2016, të zërit "Shtesa/pakësime likuiditete *cas*h dhe bankë"[55] në vitet 2014 dhe 2015.

**29.5.** Për sa i përket pretendimit lidhur me ndryshimin e likuiditeteve, se Komisioni ka pasqyruar gabim balancat e gjendjeve të depozitave/llogarive në {***} të subjektit të rivlerësimit në vitin 2009[56], trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk është i mbështetur për sa trajtuar më poshtë.

---

*për udhëtimet kur kanë qëndruar te të afërmit, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e qëndrimit ditore nuk duhet të llogariten 80 euro [ose 4 persona x 20 euro = 80 euro/dita], duke e konsideruar si të lartë këtë shpenzim.*

[54] *Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 18.07.2019.*

[55] *Pasi zëri "Shtesa/pakësime likuiditete cash dhe bankë" llogaritet si diferencë "Total likuiditete" të vitit 2014 - "Total likuiditete" të vitit 2013, për analizën e vitit 2014, dhe si diferencë "Total likuiditete" të vitit 2015 - "Total likuiditete" të vitit 2014, për analizën e vitit 2015.*

[56] *Duke e shtuar me një llogari me balancë 442.250 lekë dhe një llogari tjetër me balancën +158.604 lekë.*

**29.5.1.** Konkretisht, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka përfshirë gabimisht një balancë prej 442.250 lekësh, e cila nuk i përket subjektit të rivlerësimit dhe balanca në lekë e evidentuar nga Komisioni, në shumën 1.000.000 lekë, duhet të ishte 841.396 lekë.

**29.5.2.** Pas verifikimit të lëvizjeve të llogarisë bankare në lekë, në {***}, të subjektit të rivlerësimit, me nr. {***}[57], llogaria e pagës e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në fund të vitit 2009, ndryshe nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka evidentuar saktë balancat, pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje depozitat 1.000.000 lekë dhe 442.250 lekë në {***}[58].

**29.6.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me ndryshimin e likuiditeteve, se depozitat e investuara në sistemin bankar kanë qenë në monedhën euro dhe USD dhe, si rezultat i kursit të këmbimit të kohës dhe masës së depozitave bankare, konvertimi i tyre në lekë ka rezultuar me një rivlerësim të likuiditeteve, përkatësisht në vitin 2009, në shumën (+) 87.138 lekë; në vitin 2012, në shumën (+) 32.180 lekë; në vitin 2014, në shumën (+) 144.533 lekë; në vitin 2015, në shumën (+) 158.542 lekë, trupi gjykuesi Kolegjit vëren sa trajtuar më poshtë.

**29.6.1.** Lidhur me efektin e rivlerësimit të likuiditeteve ndër vite, për shkak të ndryshimeve të kursit të këmbimit të kohës e masës së likuiditeteve në monedha të huaja, konvertimi i tyre në lekë ndër vite, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit, duke dhënë efekte në analizën financiare sikurse trajtohet në vitet përkatëse.

**29.6.2.** Për pretendimin për *rivlerësim valute* në vitet 2009, 2012, 2014 dhe 2015, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se depozitat e krijuara më parë mbartin dhe efektet e kurseve të këmbimit nga momenti i krijimit të tyre dhe në vitet në vijim, pasi likuiditetet në monedhë të huaj në vitin 2009, prej 4.350 eurosh dhe 9.995 USD, në {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit kanë filluar krijimin e tyre që në vitin 2004[59].

---

[57] *Bashkëlidhur shkresës së {***} nr. {***} prot., datë 1.02.2019, dërguar Komisionit.*

[58] *Depozita prej 800.000 lekësh, që ka qenë gjendje në fund të vitit 2008, në llogarinë bankare në {***}, nr. {***}, në emër të znj. Anila Guri, është maturuar më 07.01.2009, në shumën 842.596,4 lekë, vlera prej 841.396 lekësh ka kaluar në llogarinë në lekë, nr. {***} [llogarinë e pagës së subjektit] në po të njëjtën bankë dhe, së bashku me gjendjen që ka pasur në këtë llogari, po në datë 7.1.2009, shuma prej 1.000.000 lekësh, është vendosur depozitë deri më 7.01.2010, me përshkrimin në llogari: "{***}". Në datën 7.1.2010, po në këtë llogari, llogaria e pagës e subjektit të rivlerësimit, maturohet depozita në shumën 1.058.500,01 lekë, me përshkrimin: "{***}". Depozita prej 442.250 lekësh – referuar lëvizjeve të llogarisë së pagës, nr. {***}, të subjekti të rivlerësimit në {***}, shuma prej 442.250 lekësh, e cila ka qenë gjendje e llogarisë, në datën 7.7.2009 debitohet llogaria me përshkrimin "dep inc to 7Jan10" e vendoset depozitë deri më datën 7.1.2010. Në datën 7.1.2010, po në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit, pra në të njëtën llogari, maturohet depozita në shumën 451.680,46 lekë, me përshkrimin: "{***}". E më tej, të dyja këto depozita të maturuara, shuma në total prej 1.586.500 lekësh, po në datë 7.01.2010, tërhiqet nga znj. Anila Guri me përshkrimin: "{***}".*

[59] *Për këtë, në Kolegj, në analizat në vijim, për të mos pasur efekt të ndryshimeve të kursit në momentin e konvertimit të likuiditeteve në monedhë të huaj në lekë, është ndjekur një parim i përgjithshëm se likuiditetet janë konvertuar nga monedhat e tyre origjinale USD/euro në lekë, me kursin e vitit të krijimit të tyre, dhe për vitet në vijim që ato kanë vazhduar të jenë gjendje, është mbartur balanca e likuiditeteve [euro/ USD], konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të vitit të krijimit të tyre, duke shtuar ndryshimet e ndodhura në vitin në analizë [gjendja e tyre në monedhën origjinale – euro/ USD – nga viti në analizë, duke zbritur gjendjen me vitin e mëparshëm], e cila është konvertuar me kursin e vitit në analizë. Po ashtu, dhe për vitet në vijim, është konsideruar e mbartur balanca e likuiditeteve në euro/ USD, e konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të vitit të mëparshëm, duke shtuar ndryshimet e ndodhura në vitin në analizë [gjendja e tyre në monedhën origjinale –euro/ USD -nga viti në analizë duke zbritur gjendjen me vitin e mëparshëm] e cila është konvertuar me kursin e vitit në analizë. Gjithashtu, në ndryshim nga praktika në Kolegj [që*

**29.6.3.** Sipas përllogaritjeve të likuiditeteve në bankë të kryera në Kolegj, në krahasim me likuiditet e evidentuara nga Komisioni në vendim, në f. 31, dhe nga subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vëren: a) likuiditete të papërfshira në vitin 2013 në llogarinë nr. {***} në Bankën e Shipërisë, në emër të znj. Anila Guri në fund të vitit 2013, gjendja prej 29.047,54 lekësh[60], dhe në vitin 2016, në llogarinë në {***}, nr. {***}, në emër të znj. Anila Guri, në fund të vitit 2016, gjendja prej 298.339 lekësh[61] – të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhe në deklaratën *vetting*; b) likuiditete të cilat janë konsideruar si gjendje në monedhën lekë nga Komisioni dhe subjekti i rivlerësimit, ndërkohë ato janë në monedhën euro, në {***}, në emër të bashkëshortit të subjektit, në llogarinë e ngurtësimit/e kartës *master card* nr. {***}, me balancë në fund të viteve 2014, 2015 dhe 2016 prej 440 eurosh; c) likuiditete të cilat kanë pasur balanca të ndryshme nga sa ka konstatuar Komisioni dhe subjekti i rilerësimit, në Bankën e Shqipërisë, në emër të znj. Anila Guri në fund të vitit 2014, gjendja prej 1.036.373,54 lekësh (pasi në datën 1.12.2014 është mbajtur tatim mbi fitimin shuma 3.627 lekë dhe kjo përbën diferencën e konstatuar) dhe në {***}, në emër të z. K. G., me nr. {***}, në fund të vitit 2010, gjendja prej 119.934,96 lekësh, ndryshe nga konsiderimi i Komisionit dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit, prej 115.243 lekësh.

**29.7.** Lidhur me analizën financiare të vitit 2006

**29.7.1.** Për sa përket i pretendimit se shpenzimet e udhëtimit të konsideruara nga Komisioni në analizën e vitit 2006, në shumën prej 369.872 lekësh, janë shumë të larta për të përfshirë shpenzimet e biletave të avionit për ShBA, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në këtë vlerë, përfshihen edhe shpenzimet e udhëtimeve të tjera të përllogaritura nga Komisioni, të kryera nga familja përgjatë vitit.

**29.7.2.** Sipas llogaritjeve të kryera në Kolegj, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[62], gjatë vitit 2006, shpenzimet e udhëtimit rezultuan në vlerën prej 350.486 lekësh[63], më

---

*është kursi i ditës së fundit të vitit], për konvertimet e gjendjes së likuiditeteve, është konsideruar kursi mesatar i dhjetorit të viteve përkatëse, pasi ky është kursi i përdorur nga Komisioni dhe nga subjekti në ankim.*

[60] *Sipas "Kartela e Klientit", dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Komision me nr. {***} prot, datë 16.07.2019, si dhe dokumenteve në dosjen e ILDKPKI-së.*

[61] *Sipas lëvizjeve të llogarisë, bashkëlidhur shkresës së {***}-së, dërguar Komisionit, me nr. {***} prot., datë 13.02.2019.*

[62] *Shih vendimin nr. 11/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

[63] *Si total i udhëtimeve në datat:* ***(i)*** *05-09.03.2006, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë, me autoveturë, subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe djali i tyre K. G., duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin, Kosturi, Greqi dhe për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime prej 70.597 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 euro/dita/ të rriturit x 2 veta x 4 ditë = 400 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 4 ditë = 100 euro, total 500 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 73,58 euro [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 1,085225 euro/litër = 33,58 euro + 40 euro kartoni jeshil = 73,58 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 573,58 euro x 123,08 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 70.597 lekë];* ***(ii)*** *17-24.09.2006, dalje/hyrje nga pika kufitare Porti Durrës, me traget dhe automjetin e tyre, subjekti, bashkëshortja dhe djali i tyre K. G., duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti (Bari, Itali) dhe për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime prej 165.108 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 euro/dita/ të rriturit x 2 veta x 7 ditë = 700 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 7 ditë = 175 euro, total 875 euro; shpenzime udhëtimi me traget 50 euro/rrugë/ të rriturit dhe fëmijë x 2 rrugë (vajtje & ardhje) x 3 veta = 300 euro + për automjetin 60 euro/rrugë x 2 rrugë (vajtje dhe ardhje) = 120 euro, total 420 euro; automjetit, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime nga porti në qendër të Barit, kur nuk kemi informacion të saktë ku ka qëndruar, prej 46,45 eurosh [84 km vajtje dhe ardhje – porti i Barit/ Bari qendër x 7 litra/ 100 km x 1,096695 euro/litër = 6,45 euro + 40 euro kartoni jeshil = 46,45 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi dhe trageti 1.341,45 euro x*

pak se Komisioni që i ka përllogaritur shumën prej 442.936 lekësh (92.450 lekë më pak) dhe më shumë se sa ka pretenduar subjekti në ankim, prej 95.545 lekësh [ose 1.020 USD], për arsye se përveç udhëtimit në ShBA, familja e subjektit të rivlerësimit kishte kryer edhe udhëtime të tjera.

**29.7.3.** Për efekt të analizës financiare të vitit 2006, në Kolegj, u kryen përllogaritjet përkatëse:

- **a)** duke konsideruar pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe përllogaritur shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në ShBA sipas analizës së Komisionit, por duke përfshirë në llogaritje edhe udhëtimet e tjera të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit dhe duke rezultuar 350.486 lekë më pak se Komisioni [llogaritur prej 442.936 lekësh], por më shumë se përllogaritjet e subjektit të rivlerësimit;
- **b)** duke rrillogaritur "Shtesa/pakësime, likuiditet *cash* dhe bankë", të cilat vijnë si pasojë e pretendimit të rivlerësimit të likuiditeteve në valutë [trajtuar më sipër];
  duke e ndryshuar efektin e këtij zëri si efekt i "rritjes" në total të likuiditeteve në bankë (si kombinim i uljes së likuiditeteve në lekë dhe rritjes së likuiditeteve në monedhën USD dhe euro) me shtesë 11.396,53 lekë;
- **c)** duke rillogaritur "Të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave", sipas lëvizjeve të llogarive bankare, rezultojnë të jenë marrë 52,74 euro nga depozita në euro në {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe 97,59 USD në {***}, në depozitën në USD në emër të subjektit të rivlerësimit, konvertuar me kursin mesatar të dhjetorit, përkatësisht të euros dhe USD, ose 15.666 lekë më shumë se sa përllogaritur nga Komisioni, prej 11.532 lekësh [më shumë + 4.134 lekë]; dhe

duke rillogaritur "Të ardhura nga punësimi, subjekti" në vlerësim të akteve në fashikuj, sipas vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (aneksi 4/16, fashikulli ILDKPKI), në të cilin për muajt qershor – dhjetor 2006, nuk ka të dhëna, e sipas shkresës nr. {***}, prot., datë 11.02.2019, të ISSh-së, Drejtoria e Arkivit Qendror, për këtë periudhë, vërteton se ka qenë me leje lindjeje, përkon dhe me periudhën e lindjes së djalit K. G., në datën 27.06.2006. Sipas lëvizjeve në llogarinë e subjektit të rivlerësimit të pagës pranë {***},, nr. {***}, (bashkëlidhur shkresës që banka i ka dërguar Komisionit nr. {***}, prot., datë 4.2.2019), konstatohet se janë kaluar të ardhura nga paga dhe shpërblime në total 709.935 lekë, të cilat janë konsideruar në analizën e vitit të kryer në Kolegj, ndryshe nga sa konsideruar nga Komisioni prej 374.995 lekësh.

**29.7.4.** Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur i rezultuan me diferencë më të vogël të pajustifikuar me burime të ligjshme, në shumën prej (-) 38.042 lekësh[64], në ndryshim nga vlera që i ka rezultuar Komisionit, prej (-) 434.268 lekësh.

---

*123,08 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 165.108 lekë]; **(iii)** 08.05.2006 - 26.07.2006, subjekti ka udhëtuar për në ShBA dhe ka qënë shtatzënë me djalin e dytë, K. G., të cilin e ka lindur atje dhe gjatë përgjigjeve të pyetësorëve, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka shpjeguar se ka qëndruar te xhaxhai i bashkëshortit (N. G.) dhe nuk ka bërë asnjë shpenzim akomodimi dhe ushqimi, pasi ka qëndruar te banesa e tij. Në vijim të përllogaritjeve të Komisionit, si kosto qëndrimi 10 USD/ditë, duke konsideruar shpenzime qëndrimi prej 5 USD/dita për subjektin dhe për djalin nga momenti lindjes deri te kthimi në Shqipëri, pra për udhëtimin në total, vlerën prej 114.781 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 USD/dita/ subjekti x 1 person x 79 ditë = 395 USD dhe për fëmijën 5 USD/dita x 29 ditë (nga dita lindjes 27.06.2006 deri ditën e kthimit) = 145 USD; në total, kosto qëndrimi 540 USD, shpenzime për bileta avioni për subjektin, vajtje dhe ardhje prej 600 USD dhe për fëmijën vetëm për kthimin, 30 USD, në total 630 USD; në total, së bashku me kosto qëndrimi 1.170 USD x 98,10, kursi mesatar vjetor i këmbimit = 114.781 lekë].*

[64] *Si rezultat (a) i të ardhurave në total prej 725.601 lekësh, rritur nga Komisioni prej + 339.074 lekësh, si rezultat i konsiderimit të pagave të përfituara nga subjekti sipas lëvizjeve bankare dhe interesave bankarë, zbritur (b) shpenzime në total prej 752.246 lekësh, pakësuar nga Komisioni 92.451 lekë, sipas përllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit,*

**29.8.** Në lidhje me analizën financiare të vitit 2009

**29.8.1.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e udhëtimit janë më të ulëta, për arsye se kanë zgjatur vetëm për disa orë, trupit gjykues të Kolegjit, bazuar në të dhënat e udhëtimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familja jashtë vendit, sipas raportit TIMS, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[65], i rezultuan në vlerën prej 429.577 lekësh[66], duke qenë 31.314 lekë më pak se vlera e llogaritur në Komision, prej 460.891 lekësh.

---

*zbritur (c) pasuri në total prej 11.396,53 lekësh, ndryshim nga Komisioni referuar pretendimit për rivlerësimin e likuiditeteve në monedha të huaja.*

[65] *Shih vendimin nr. 11/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Aplimit.*

[66] *Si total i udhëtimeve në datat: **(i)** 11-15.04.2009, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë me autoveturë, subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe dy djemtë e tyre, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Kosturi, Greqi) dhe për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime prej 83.210 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 euro/dita/të rriturit x 2 veta x 4 ditë = 400 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 4 ditë = 100 euro + 15 euro/dita/ fëmijë 0 - 5 vjeç x 1 fëmijë x 4 ditë = 60 euro, total 560 euro; shpenzime udhëtimi me automjet sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 70.10 eurosh [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 0,97294 euro/litër = 30,10 euro + 40 euro kartoni jeshil = 70,10 euro, në total së bashku me kosto qëndrimi 630,1 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 83.210 lekë]; **(ii)** 08-09.05.2009, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë me autoveturë, subjekti dhe bashkëshorti, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin, Kosturi, Greqi dhe për udhëtimin, përllogaritur shpenzime prej 22.500 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro, total 100 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 70,38 eurosh [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/Kapshticë/Kostur x 7 litra/100 km x 0,981755 euro/litër = 30,38 euro + 40 euro kartoni jeshil = 70,38 euro, në total, së bashku me kosto qëndrimi 170,38 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 22.500 lekë]; **(iii)** 17.06.2009, dalje/hyrje brenda ditës nga pika kufitare Morinë me autoveturë – konsideruar kosto e plotë ditore prej 50 eurosh – bashkëshorti i subjektit, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Prizreni, Kosovë) dhe për udhëtimin, përllogaritur shpenzime prej 10.124 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 1 vetë x 1 ditë = 50 euro, total 50 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 26,67 eurosh [372 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Morinë/Prizren x 7 litra/ 100 km x 1,024026 euro/litër = 26,67 euro + 0 euro kartoni jeshil = 26,67 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 76,67 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 10.124 lekë.]; **(iv)** 4.07.2009, ka vetëm dalje nga pika kufitare Morinë me autoveturë – është konsideruar një ditë udhëtim, pra se janë kthyer në datën 5.07.2009, duke qenë se nuk ka datë hyrje në Shqipëri, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, subjekti, bashkëshorti dhe djali K., duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Prizreni, Kosovë) dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 20.004 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 1 ditë = 125 euro, total 125 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 26,48 euro [372 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Morinë/Prizren x 7 litra/ 100 km x 1,0169175 euro/litër = 26,48 euro + 0 euro kartoni jeshil = 26,48 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 151,48 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 20.004 lekë]; **(v)** 20.07.2009, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje brenda ditës nga pika kufitare Morinë me autoveturë – konsideruar kosto e plotë ditore prej 50 euro - , bashkëshorti i subjektit, duke qënë se nuk ka destinacion është konsideruar më i afërti me kufirin (Prizreni, Kosovë) dhe për udhëtimin, përllogaritur shpenzime prej 10.100 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 1 vetë x 1 ditë = 50 euro, total 50 euro; shpenzime udhëtimi me automjet sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 26,48 euro [372 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Morinë/Prizren x 7 litra/ 100 km x 1,0169175 euro/litër = 26,48 euro + 0 euro kartoni jeshil = 26,48 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 76,48 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 10.100 lekë.]; **(vi)** 29.07-06.08.2006, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje nga pika kufitare Porti Durrës, me traget dhe automjetin e tyre, subjekti, bashkëshortja dhe dy djemtë, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti (Bari, Itali) dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 222.647 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 euro/dita/ të rriturit x 2 veta x 8 ditë = 800 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 8 ditë = 200 euro + 15 euro/dita/ fëmijë 0-5 vjeç x 1 fëmijë x 8 ditë = 120 euro, total 1120 euro; shpenzime udhëtimi me traget 50 euro/rrugë/ të rriturit &/fëmijë x 2 rrugë (vajtje & ardhje) x 4 veta = 400 euro + për automjetin 60 euro/rrugë x 2 rrugë (vajtje & ardhje) = 120 euro, total 520 euro; automjetit, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime nga porti në qendër të Barit, kur*

**29.8.2.** Për efekt të analizës financiare të vitit 2009, në Kolegj, u kryen rillogaritjet duke konsideruar pretendimet e subjektit të rivlerësimit

**a)** për "Shtesa/pakësime likuiditet *cash* dhe bankë", të cilat vijnë si pasojë e pretendimit të efektit të rivlerësimit të likuiditeteve në valutë, në të cilën në përllogaritjet në Kolegj, duke e ndryshuar efektin e këtij zëri si efekt i "rritjes" në total të likuiditeteve në bankë, rezulton në shumën shtesë prej 907.068 lekësh, që e krahasuar me Komisionin, del 88.556 lekë më pak [nga vlera 995.623 lekë] e me diferencë prej 1.418 lekësh, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, për "rivlerësim valute" prej 87.138 lekësh;

**b)** duke rillogaritur "Shpenzimet e udhëtimit" sipas metodologjisë në Kolegj, duke u llogaritur më pak në krahasim me përllogaritjen e Komisionit, në shumën 31.314 lekë;

**c)** duke rillogaritur "Të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave" sipas lëvizjeve të llogarive bankare, rezultojnë të jenë marrë 41.396,4 lekë nga depozita në lekë, në {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit; 242,76 euro nga depozita në euro, në {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit;; dhe 231,57 USD në {***}, në depozitën, në USD, në emër të subjektit të rivlerësimit, konvertuar me kursin mesatar të dhjetorit, përkatësisht të euros dhe USD, pra më pak se Komisioni, në shumën prej 32.781 lekësh; si dhe

**ç)** duke lënë elementet e tjera në analizë sipas Komisionit.

**29.8.3.** Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit, për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur i rezultuan me diferencë më të vogël të pajustifikuar me burime të ligjshme, në shumën 707.226 lekë[67], në ndryshim nga vlera e llogaritur në Komision, prej 794.311 lekësh.

---

*nuk kemi informacion të saktë ku ka qëndruar, prej <u>45,98 eurosh</u> [84 km vajtje dhe ardhje porti i Barit/ Bari qendër x 7 litra/ 100 km x 1,0169175 euro/litër = 5,98 euro + 40 euro kartoni jeshil = 45,98 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi e tragetin, 1.685,98 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = <u>222.647 lekë</u>]; **(vii)** 26-27.08.2009, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë, me autoveturë, subjekti dhe bashkëshorti, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Kosturi, Greqi) dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej <u>22.776 lekësh</u> [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro, total <u>100 euro</u>; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej <u>72,47 euro</u> [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 1,049472 euro/litër = 32,47 euro + 40 euro kartoni jeshil = 72,47 euro; në total, së bashku, me kosto qëndrimi 172,47 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = <u>22.776 lekë</u>]; **(viii)** 12.09.2009, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje brenda ditës nga pika kufitare Morinë me autoveturë – konsideruar kosto e plotë ditore prej 50 eurosh – bashkëshorti i subjektit, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Prizreni, Kosovë) dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej <u>10.134 lekësh</u> [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 1 vetë x 1 ditë = 50 euro, total 5<u>0 euro</u>; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej <u>26.74 eurosh</u> [372 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Morinë/Prizren x 7 litra/ 100 km x 1,0269625 euro/litër = 26,74 euro + 0 euro kartoni jeshil = 26,74 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 76,74 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = <u>10.134 lekë</u>] ; **(ix)** 29.11.2009, ka vetëm hyrje nga pika kufitare Kapshticë, me autoveturë – është konsideruar një ditë udhëtim, pra se kanë dalë në datën 28.11.2009, duke qenë se nuk ka datë daljeje nga Shqipëria; për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Kosturi, Greqi) dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej <u>28.081 lekësh</u> [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 1 ditë = 25 euro + 15 euro/dita/ fëmijë 0-5 vjeç x 1 fëmijë x 1 ditë = 15 euro, total <u>140 euro</u>; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej <u>72,64 eurosh</u> [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 1,055016 euro/litër = 32,64 euro + 40 euro kartoni jeshil = 72,64 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 212,64 euro x 132,06 kursi mesatar vjetor i këmbimit = <u>28.081 lekë</u>].*

[67] *Si rezultat i (a) të ardhurave në total, prej 2.075.900 lekësh, ulur nga Komisioni me -32.783 lekë, si rezultat i llogaritjes së interesave nga depozitat bakare, zbritur (b) shpenzime në total, prej 976.057 lekësh, pakësuar nga*

**29.9.** Në lidhje me analizën financiare të vitit 2011

**29.9.1.** Për sa u përket interesave nga depozitat bankare, të përfituar në vitin 2011, trupit gjykues i rezultuan në vlerat prej 35.902,61 lekësh, 202,82 eurosh dhe 37,71 USD, ose ekuivalenti prej 67.915,18 lekësh, që janë 19.084,82 lekë më pak nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, në vlerën prej 87.000 lekësh, si dhe 5.613 lekë më pak nga sa ka llogaritur Komisioni, në vlerën prej 73.528 lekësh.

**29.9.2.** Për sa u përket shpenzimeve të udhëtimit në bazë të të dhënave sipas raportit TIMS, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[68], në vitin 2011, trupit gjykues të Kolegjit i rezultuan në vlerën prej 324.171 lekësh[69], prej 57.537 lekësh më pak se vlera e llogaritur në

---

*Komisioni 31.314 lekë, sipas përllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit, zbritur (c) pasuri në total prej 1.807.068 lekësh, ndryshim nga Komisioni referuar pretendimit për rivlerësimin e likuiditeteve në monedha të huaja.*

[68] *Shih vendimin nr. 11/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

[69] *Si total i: **(i)** 19-22.03.2011, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë me autoveturë, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë e tyre, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Kosturi, Greqi) dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 70.562 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 euro/dita/ të rriturit x 2 veta x 3 ditë = 300 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 3 ditë = 75 euro + 15 euro/dita/ fëmijë 0-5 vjeç x 1 fëmijë x 3 ditë = 45 euro, total 420 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 82,83 eurosh [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 1,3842525 euro/litër = 42,83 euro + 40 euro kartoni jeshil = 82,83 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 502,83 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 70.562 lekë];**(ii)** 30.04.2011, ka vetëm dalje nga pika kufitare Murriqan, me autoveturë – është konsideruar një ditë udhëtim, pra se janë kthyer në datën 1.05.2011, duke qenë se nuk ka datë hyrjeje në Shqipëri, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Ulqini, Mali i Zi) dhe, për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 25.569 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 1 ditë + 15 euro/dita/ fëmijë 0-5 vjeç x 1 fëmijë x 1 ditë = 140 euro, total 140 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 42,2 eurosh [278 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Murriqan/Ulqin x 7 litra/ 100 km x 1,39797 euro/litër = 27,2 euro + 15 euro kartoni jeshil = 42,2 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 182,2 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 25.569 lekë]; **(iii)** 29-31.05.2011, 30.06 – 03.07.2011, dhe 12-17.07.2011, bashkëshorti ka udhëtuar me avion për në Itali, sipas përgjigjeve në pyetësor dhe në përgjigje të rezultateve hetimore, subjekti ka shpjeguar se ka vajtur te vëllai i tij në Itali, pasi ka pasur probleme shëndetësore ato kohë. Për të tria udhëtimet janë përllogaritur shpenzime prej 54.729 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 eurosh/dita/ të rriturit x 1 vetë x 10 ditë [2 ditë + 3 ditë + 5 ditë] = 50 euro, total 50 euro; shpenzime udhëtimi me avion, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 340 eurosh [me linjën Belle Air Forli LBY 278 x 2 herë vajtje/ardhje = 200 euro + me linjën Belle Air Forli LBY vajtje 50 euro + me linjën Alitalia AZ 506/511 MILANO ardhje, prej 90 eurosh], në total, së bashku me kosto qëndrimi 390 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 54.729 lekë]; **(iv)** 04-06.11.2011, bashkëshorti, subjekti dhe djali K. kanë udhëtuar me avion për në Venecia, Itali, sipas përgjigjeve në pyetësor dhe në përgjigje të rezultateve hetimore, subjekti ka shpjeguar se kanë qenë të ftuar nga miku i tyre A. H., me rasin e ditëlindjes së tij, dhe janë mbuluar prej tij të gjitha kostot. Bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, ka bashkëlidhur dhe deklaratë të thjeshtë të z. A. H., datë 04.11.2011, ku shprehet se shpenzimet e udhëtimit e qëndrimit e akomodimit janë mbuluar prej tij dhe bashkëshortes së tij. Për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 eurosh/ dita / secili, si dhe janë konsideruar dhe shpenzime për avionin, pasi nuk është provuar pagesa prej të ftuarve, në total prej 42.801 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 eurosh/dita/ të rriturit x 3 veta x 2 ditë = 30 euro, total 30 euro; shpenzime udhëtimi me avion, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 275 eurosh [me linjën Belleair Venecia 673-674 x 2 herë vajtje/ardhje x 2 veta = 200 euro + me linjën Belleair Venecia 673-674 x 2 herë vajtje/ardhje x 1 fëmijë 11,2 vjeç prej 75 eurosh]; në total, së bashku me kosto qëndrimi 305 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 42.801 lekë]; **(v)** 10.08.2011, ka vetëm hyrje nga pika kufitare Qafë Morini me autoveturë – është konsideruar një ditë udhëtim, pra se kanë dalë në datën 9.08.2011, duke qenë se nuk ka datë dalje nga Shqipëria, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, subjekti, bashkëshorti dhe djali K., duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Gjakovë, Kosovë)*

Komision, prej 381.708 lekësh.

**29.9.3.** Për efekt të analizës financiare të vitit 2011, në Kolegj, u kryen përllogaritjet përkatëse:

**a)** duke konsideruar pretendimet e subjektit të rivlerësimit për "Shtesa/pakësime në likuiditet *cash* dhe bankë", të cilat vijnë si pasojë e efektit të rivlerësimit të likuiditeteve në valutë, duke e ndryshuar efektin e këtij zëri si efekt i "rritjes" në total të likuiditeteve në bankë (si kombinim i rritjes së likuiditeteve në lekë dhe në monedhën USD dhe euro). Pra, "shtesë" e likuiditeteve në total, por më e ulët se përllogaritjet e Komisionit [nga 815.967 lekë në 802.185 lekë, me diferencë prej -13.782 lekësh]; duke rillogaritur "Shpenzimet e udhëtimit" sipas metodologjisë në Kolegj, duke u ulur në krahasim me përllogaritjet e Komisionit [-57.537 lekë];

**b)** duke saktësuar "Të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave", sipas lëvizjeve të llogarive bankare trajtuar më sipër; si dhe

**c)** duke lënë elementet e tjera në analizë sipas Komisionit.

**29.9.4.** Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur i rezultuan me diferencë më të vogël të pajustifikuar me burime të ligjshme, në shumën

---

*dhe, për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 24.775 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 1 ditë = 125 euro, total 125 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 51,55 eurosh [540 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Qafë Morini/Gjakovë x 7 litra/ 100 km x 1,3637875 euro/litër = 51,55 euro + 0 euro kartoni jeshil = 51,55 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 177 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 24.775 lekë.]; **(vi)** 11.08.2011, ka vetëm dalje nga pika kufitare Qafë Morini me autoveturë – është konsideruar një ditë udhëtim, pra se ka hyrë në datën 12.08.2011, duke qenë se nuk ka datë hyrje në Shqipëri, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, bashkëshorti, e duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Gjakovë, Kosovë) dhe, për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 14.251 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 1 person x 1 ditë = 50 euro, total 50 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 51,55 eurosh [540 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Qafë Morinë/Gjakovë x 7 litra/ 100 km x 1,3637875 euro/litër = 51,55 euro + 0 euro kartoni jeshil = 51,55 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 101,55 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 14.251 lekë]; **(vii)** 28-30.08.2011, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë, me autoveturë, subjekti, bashkëshorti dhe djali K., duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Kosturi, Greqi) dhe, për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 46.617 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 2 ditë = 200 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 2 ditë = 50 euro , total 250 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 82,2 euro [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 1,3637875 euro/litër = 42,20 euro + 40 euro kartoni jeshil = 82,2 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 332,2 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 46.617 lekë]; **(viii)** 21-22.10.2011, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë me autoveturë, subjekti dhe bashkëshorti, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Kosturi, Greqi) dhe, për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 25.668 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro, total 100 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 82,91 eurosh [442 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Kapshticë/Kostur x 7 litra/ 100 km x 1,386958 euro/litër = 42,91 euro + 40 euro kartoni jeshil = 82,91 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 182,91 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 25.668 lekë]; **(ix)** 12.11.2011, ka vetëm hyrje nga pika kufitare Morinë, me autoveturë – është konsideruar një ditë udhëtim, pra se kanë dalë në datën 11.11.2011, duke qenë se nuk ka datë daljeje nga Shqipëria, për të cilin nuk ka shpjegime në pyetësor, subjekti dhe bashkëshorti, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Prizreni, Kosovë) dhe, për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 19.200 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro, total 100 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 36,82 euro [372 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Morinë/Prizren x 7 litra/ 100 km x 1,4139125 euro/litër = 36,82 euro + 0 euro kartoni jeshil = 36,82 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 136,82 euro x 140,33 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 19.200 lekë].*

prej (-) 167.863 lekësh[70], në ndryshim nga vlera që i rezultoi Komisionit prej (–) 233.568 lekësh.

**29.10.** Në lidhje me analizën financiare të vitit 2012

**29.10.1.** Për sa u përket shpenzimeve të udhëtimit në bazë të të dhënave sipas raportit TIMS-it, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[71], në vitin 2012, trupit gjykues të Kolegjit i rezultuan në vlerën prej 2.515,78 eurosh ose 349.795 lekësh[72], me një diferencë të vogël me

---

*[70] Si rezultat i: a) Të ardhura në total prej 1.504.974 lekë, ulur nga Komisioni prej -5.613 lekë, si rezultat i llogaritjes së interesave nga depozitat bankare, zbritur b) shpenzime në total prej 870.651 lekë, pakësuar nga Komisioni 57.537 lekë sipas përllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit, zbritur c) pasuri në total prej 802.185 lekë, ndryshim nga Komisioni referuar pretendimit për rivlerësimin e likuiditeteve në monedha të huaja.*

*[71] Shih vendimin nr. 11/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

*[72] Si total i: **(i)** 21.04.2012, ka vetëm dalje nga pika kufitare Morinë me autoveturë – është konsideruar udhëtim brenda ditës, pra se kanë hyrë po në datën 21.04.2012 sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin nr. {***}, duke qenë se nuk ka destinacion, është konsideruar më i afërti me kufirin (Prizren, Kosovë), subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë e tyre, dhe për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime prej 26.343 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 të rritur + 25 euro/dita/ fëmijë 5 - 18 vjeç x 2 fëmijë, total 150 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 39,46 eurosh [372 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Morinë/Prizren x 7 litra/ 100 km x 1,5154025 euro/litër = 39,46 euro + 0 euro kartoni jeshil = 39,46 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 189,46 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 26.343 lekë]; **(ii)** 24.02.2012, ka dalje/hyrje nga pika kufitare Murriqan, me autoveturë, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, pra udhëtim brenda ditës, duke qenë se nuk ka destinacion të deklaruar, është konsideruar më i afërti me kufirin (Ulqin, Mali i Zi), dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 13.070 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 1 i rritur, total 50 euro; shpenzime udhëtimi me automjet sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 44 eurosh [278 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Murriqan/Ulqin x 7 litra/ 100 km x 1,4904575 euro/litër = 29 euro + 15 euro kartoni jeshil = 44 euro; në total, së bashku, me kosto qëndrimi 94 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 13.070 lekë]; **(iii)** 12.08.2012, ka vetëm dalje nga pika kufitare Murriqan me autoveturë – është konsideruar udhëtim brenda ditës, pra se kanë hyrë po në datën 12.08.2012, e me destinacion Ulqin, sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin nr. {***}, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë e tyre, dhe për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 27.070 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 të rritur + 25 euro/dita/ fëmijë 5 - 18 vjeç x 2 fëmijë, total 150 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 44,69 eurosh [278 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Murriqan/Ulqin x 7 litra/ 100 km x 1,52583 euro/litër = 29,69 euro + 15 euro kartoni jeshil = 44,69 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 194,69 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 27.070 lekë]; **(iv)** 18.08.2012, bashkëshorti ka dalje/hyrje nga pika kufitare Hani i Hotit me autoveturë – pra udhëtim brenda ditës, me destinacion Podgoricë sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin nr. {***}, dhe për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime prej 11.793 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 1 i rritur, total 50 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 34,82 eurosh [326 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Hani i Hotit/Podgoricë x 7 litra/ 100 km x 1,52583 euro/litër = 34,82 euro + 0 euro kartoni jeshil, konsideruar i udhëtimit më parë = 34,82 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 84,82 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 11.793 lekë]; **(v)** 29.09.2012, bashkëshorti dhe subjekti i rivlerësimit kanë dalje nga pika kufitare Hani i Hotit me autoveturë – është konsideruar udhëtim brenda ditës, pra se kanë hyrë po në datën 29.09.2012 e me destinacion Tuz, Mali i Zi, si vendi më i afërt me pikën kufitare pasi nuk ka destinacion të deklaruar. Gjithashtu dhe në datën 08.12.2012, bashkëshorti dhe subjekti i rivlerësimit kanë dalje/hyrje nga pika kufitare Hani i Hotit me autoveturë, është konsideruar si destinacion po Tuz, Mali i Zi, pasi nuk ka të deklaruar, dhe për të dyja udhëtimet janë përllogaritur shpenzime prej 41.045 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 të rritur x 2 ditë, total 200 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 95,20 eurosh [310 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Hani i Hotit/Tuz x 7 litra/ 100 km x 1,532435 euro/litër dhe 1,47228 euro/litër = 65,2 euro + 30 euro kartoni jeshil (për dy udhëtimet)= 95,2 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 295,2 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 41.045 lekë]; **(vi)** 09-12.03.2012, udhëtim me avion, subjekti i rivlerësimi, bashkëshorti dhe djali K. G. (11,5 vjeç), sipas shpjegimeve në pyetësorin nr. {***}: "turizëm, paketë turistike e ATHS, tek hotel "{***}",{***}, Paris, Francë", janë përllogaritur shpenzime prej 1.062,5 eurosh ose 147.730 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 të rritur x 3 ditë + 25 euro/ fëmijë x 1 fëmijë x 3 ditë, total 375 euro, djali 11,5 vjeç, sipas metodologjisë për paketa turistike, i përllogaritet kosto*

Komisionin, që e ka përllogaritur shumën prej 352.094 lekësh (2.299 lekë më pak), si dhe më shumë nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në ankim, në shumën 1.660 euro ose 230.740 lekë (119.055 lekë më shumë), diferencë kjo më e madhe prej kostos së biletave të avionit për udhëtimin në Francë dhe për koston e qëndrimit për udhëtimet brenda ditës në shtetet kufitare.

**29.10.2.** Për efekt të analizës financiare të vitit 2012, në Kolegj, u kryen përllogaritjet përkatëse:

**a)** duke konsideruar efektin e rivlerësimit për "Shtesa/pakësime në likuiditet *cash* dhe në bankë", të cilat vijnë si pasojë e efektit të rivlerësimit të likuiditeteve në valutë [trajtuar më sipër]. Efekti i këtij zëri që ndryshon si pasojë e "rritjes" në total të likuiditeteve në bankë, rezulton në shumën shtesë prej 680.496 lekësh, e cila, e krahasuar me Komisionin, rezulton 32.096 lekë më pak [nga vlera 712.593 lekë] e me diferencë prej 83 lekësh më pak, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit për "rivlerësim valute" prej 32.180 lekësh; dhe

**b)** duke rillogaritur "Shpenzimet e udhëtimit" sipas metodologjisë në Kolegj, me një diferencë të vogël në krahasim me përllogaritjet e Komisionit [-2.299 lekë]; duke saktësuar "Të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave" që, sipas lëvizjeve të llogarive bankare, rezultojnë në shumën prej 147.626 lekësh[73].

---

*qëndrimi 0 euro/ditë; shpenzime udhëtimi me avion, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 687,5 eurosh [me avion BELLEAIR - BRUKSEL 798-797/ Austrian Airlines OS 847/848 Viena, bileta me destinacione me linjë jodirekte në Evropë (connections) me destinacionin final, pra 250 euro/të rritur x 2 të rritur + 187,5 euro/ fëmijë 2 – 12 vjeç]; në total, së bashku me kosto qëndrimi 1.062,5 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 147.730 lekë]; **(vii)** 24-27.05.2012, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka udhëtuar me avion për në {***}, Itali, sipas përgjigjeve në pyetësor dhe në përgjigje të rezultateve hetimore, subjekti ka shpjeguar se ka vajtur te vëllai i tij (L.G. ) në Itali e nuk ka pasur shpenzime qëndrimi e akomodimi, por vetëm udhëtimi, të cilat kanë qenë dhe ekonomike në atë periudhë. Sipas metodologjisë në Kolegj, janë konsideruar shpenzime qëndrimi 5 euro/ dita. Për këtë udhëtim, janë përllogaritur shpenzime prej 115 eurosh ose 15.990 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 eurosh/dita/ të rriturit x 1 vetë x 3 ditë = total 15 euro; shpenzime udhëtimi me avion, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 100 eurosh [me linjën Belle Air Forli LBY vajtje/ardhje 100 euro]; në total, së bashku, me kosto qëndrimi 115 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 15.990 lekë], përllogaritjet e njëjta, sipas pretendimit të subjektit në ankim, për këtë udhëtim; **(viii)** 28-30.08.2012, për të cilin ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***}: "vizitë te halla ime (nga familja biologjike) E. M. dhe kushëriri im K. Q., rezidentë në Kavala, Greqi", si dhe në përgjigje të rezultateve hetimore se nuk ka pasur shpenzime qëndrimi e akomodimi, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. {***}, ka deklaratë, datë 12.02.2019, nga z. K. Q., i cili deklaron se ka siguruar akomodimin dhe qëndrimin e familjes së subjektit në banesën e tyre, nuk ka specifikuar kohë pasi nuk e kujton, por shprehet se subjekti dhe familja e saj kanë bërë vizita shumë të shpeshta. Sipas metodologjisë në Kolegj, janë konsideruar shpenzime qëndrimi 5 euro/ dita. Për udhëtimin janë përllogaritur shpenzime prej 198 eurosh ose 27.548 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 eurosh/dita/ të rriturit dhe fëmijët x 4 veta x 2 ditë = 40 euro, total 40 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 158,13 eurosh [1.106 km vajtje Tiranë/ Kapshticë/ Kavala x 7 litra/ 100 km x 1,52583 euro/litër = 118,13 euro + 40 euro kartoni jeshil = 158,13 euro]; në total, së bashku me kosto qëndrimi 198,13 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 27.548 lekë]; **(ix)** 29-30.11.2012, udhëtim me automjet, hyrje/dalje në pikën kufitare Kapshticë, familja, sipas shpjegimeve në pyetësorin nr. {***}: "turizëm, kemi qëndruar në hotel ose "{***}" ose "{***}"", janë përllogaritur shpenzime prej 281,97 eurosh ose 39.205 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 të rritur x 1 ditë + 25 euro/dita/fëmijët x 2 fëmijë x 1 ditë = total 150 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 131.97 eurosh [880 km vajtje Tiranë/ Kapshticë/ Selanik x 7 litra/ 100 km x 1,4930325 euro/litër = 91,97 euro + 40 euro kartoni jeshil = 131,97 euro]; në total, së bashku me kosto qëndrimi 281,97 euro x 139,04 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 39.205 lekë].*

[73] *Si total i: 50.372 lekë e depozitës në lekë e subjektit në {***} ; 61.228 lekë e bonove të thesarit në lekë e subjektit në Bankën e Shqipërisë; 126.89 euro e depozitës në euro e subjektit të rivlerësimit në {***}; 171.69 USD e depozitës në USD e subjektit të rivlerësimit në {***}.*

**29.10.3.** Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur i rezultuan me diferencë më të vogël të pajustifikuar me burime të ligjshme, në shumën prej (-) 359.439 lekësh[74], në ndryshim nga vlera që i rezultoi Komisionit prej (–) 463.433 lekësh, dhe më të lartë nga vlera e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, prej (–) 309.899 lekësh.

**29.11.** Në lidhje me analizën financiare të vitit 2014

**29.11.1.** Për efekt të analizës financiare të vitit 2014, në Kolegj, u kryen përllogaritjet përkatëse:

**a)** duke konsideruar efektet e rivlerësimit për "Shtesa/pakësime likuiditet *cash* dhe bankë", të cilat vijnë si pasojë e efektit të rivlerësimit të likuiditeteve në valutë [trajtuar më sipër], duke e ndryshuar efektin e këtij zëri si efekt i "rritjes" në total të likuiditeteve në bankë, rezulton në shumën shtesë prej 1.190.221 lekësh, që rezulton 116.138 lekë më pak nga vlera 1.306.359 lekë, e llogaritur nga Komisioni; dhe

**b)** duke saktësuar "Të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave", sipas lëvizjeve të llogarive bankare të cilat rezultojnë në shumën prej 51.209 lekësh[75], që është më e madhe se sa vlera e llogaritur nga Komisioni prej 29.074 lekësh, në shumën prej (+) 22.135 lekësh, si dhe duke lënë elementet e tjera në analizë sipas Komisionit.

**29.11.2.** Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit, për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur i rezultuan me diferencë pozitive prej (+) 53.734 lekësh[76], në ndryshim nga vlera që i rezultoi Komisionit, me diferencë të pajustifikuar me burime të ligjshme prej (–) 84.538 lekësh.

**29.12.** Në lidhje me analizën financiare të vitit 2015

**29.12.1.** Për sa u përket shpenzimeve të udhëtimit në bazë të të dhënave sipas raportit TIMS, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit[77], për vitin 2015, trupit gjykues të Kolegjit i rezultuan në vlerën prej 299.610 lekësh[78], që është 39.009 lekë më pak se Komisioni që e ka përllogaritur shumën prej 338.619 lekësh.

---

[74] *Si rezultat i (a) të ardhurave në total, prej 1.234.948 lekësh, rritur nga Komisioni prej +69.598 lekësh, si rezultat i saktësimit të interesave nga depozitat bankare, zbritur (b) shpenzime në total, prej 913.891 lekësh, pakësuar nga Komisioni -2.299 lekë, sipas përllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit, zbritur (c) pasuri në total, prej 680.496 lekësh, ndryshim nga Komisioni, referuar pretendimit për rivlerësimin e likuiditeteve në monedha të huaja.*

[75] *Si total i 12.663 lekëve të depozitës në lekë të subjektit në {***}; i 108,79 eurove të depozitës në euro të subjektit të rivlerësimit në {***}; i 205 USD-ve të depozitës në USD të subjektit të rivlerësimit në {***}.*

[76] *Si rezultat i (a) të ardhurave në total prej 2.922.575 lekësh, rritur nga Komisioni me +22.135 lekë, si rezultat i saktësimit të interesave nga depozitat bakare, zbritur (b) shpenzime në total prej 1.678.619 lekësh, njësoj si Komisioni, zbritur (c) pasuri në total, prej 1.190.221 lekësh, ndryshim nga Komisioni, referuar pretendimit për rivlerësimin e likuiditeteve në monedha të huaja.*

[77] *Shih vendimin nr. 11/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

[78] *Si total i: **(i)** 21-21.02.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm njëditor Podgoricë, Mali i Zi", dalje/hyrje nga pika kufitare Hani i Hotit me autoveturë, subjekti dhe bashkëshorti, përllogaritur shpenzime prej <u>19.988 lekësh</u> [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro, total <u>100 euro</u>; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej <u>43,03 eurosh</u> [326 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Hani i Hotit/Podgoricë x 7 litra/ 100 km x 1,22841 euro/litër = 28,03 euro + 15 euro kartoni jeshil = 43,03 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 143,03 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = <u>19.988 lekë</u>];**(ii)** 26 – 26.04.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm njëditor Tuz, Mali i Zi", dalje/hyrje nga pika kufitare Hani i Hotit me autoveturë, subjekti, bashkëshorti, djali K. G., po ashtu dhe për*

*udhëtimet në datat 29.08.2015 dhe 08.12.2015, të kryera nga subjekti dhe bashkëshorti, të cilat i ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm njëditor Mali i Zi", por nuk ka shpjeguar destinacionin, është konsideruar më i afërti me pikën kufitare dalëse (pra Tuz), janë përllogaritur shpenzime në total për tri udhëtimet, prej 62.765 lekësh [përllogaritur shpenzime për të tria udhëtimet: qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 3 ditë = 300 euro + 25 euro/dita/ fëmijë x 1 fëmijë x 1 ditë (për udhëtimin në prill 2015) = 325 euro, total 325 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 124,15 eurosh [310 km vajtje dhe ardhje Tiranë/ Hani i Hotit/Tuz x 7 litra/ 100 km x 1,290036 euro/litër/ 1,212078 euro/litër / 1,14533 euro/litër = 27,99 euro + 26,30 euro + 24,85 euro + 15 euro kartoni jeshil x 3 udhëtimet = 124,15 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 449,15 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 62.765 lekë]; **(iii)** 17 – 17.10.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***}: si "turizëm njëditor Mali i Zi", dalje nga pika kufitare Hani i Hotit e hyrje nga Murriqani, me autoveturë, subjekti dhe bashkëshorti, nuk ka shpjeguar destinacionin, është konsideruar më i afërti me pikën kufitare dalëse (Tuzi), janë përllogaritur shpenzime në total për udhëtimin prej, 20.007 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë = 100 euro, total 100 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 43,17 eurosh [155 km vajtje Tiranë/ Hani i Hotit/Tuz dhe 187 km ardhje Tuz/ Murriqan/ Tiranë x 7 litra/ 100 km x 1,1768325 euro/litër/ = 28,17 euro + 15 euro kartoni jeshil = 43,17 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 143,17 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 20.007 lekë]; **(iv)** 21 – 22.08.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm Mavrovë, hoteli nuk i kujtohet", dalje nga pika kufitare Bllade e hyrje nga Tushemishti, me autoveturë, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë, janë përllogaritur shpenzime në total për udhëtimin prej 32.610 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë + 25 euro/dita/ fëmijë 5 – 18 vjeç x 2 fëmijë x 1 ditë = 150 euro, total 150 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 83,36 eurosh [219 km vajtje Tiranë/ Blladë/Mavrovë dhe 292 km ardhje Mavrovë/ Tushemisht/ Tiranë x 7 litra/ 100 km x 1,212078 euro/litër = 43,36 euro + 40 euro kartoni jeshil = 83,36 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 233,36 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 32.610 lekë]; **(v)** 15 – 17.05.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm, hotel "{***}", Mostar, Bosnja dhe Hercegovina", dalje/hyrje nga pika kufitare Murriqan me autoveturë, subjekti dhe bashkëshorti, janë përllogaritur shpenzime në total për udhëtimin prej 43.885 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 2 ditë = total 200 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 114,04 euro [806 km vajtje/arrdhje Tiranë/ Murriqan/Monstar x 7 litra/ 100 km x 1,3122925 euro/litër = 74,04 euro + 40 euro kartoni jeshil = 114,04 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 314,04 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 43.885 lekë]; **(vi)** 23 – 24.08.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm, Lefkada, Greqi, hoteli nuk i kujtohet", dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë/Kakavijë me autoveturë, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë, janë përllogaritur shpenzime në total për udhëtimin prej 37.649 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 euro/dita/ të rriturit x 2 veta x 1 ditë + 25 euro/dita/ fëmijë 5-18 vjeç x 2 veta x 1 ditë = total 150 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 119,42 eurosh [488 km vajtje Tiranë/ Kapshticë/ Lefkada dhe ardhje Lefkada/ Kakavijë/Tiranë x 7 litra/ 100 km x 1,212078 euro/litër = 79,42 euro + 40 euro kartoni jeshil = 119,42 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 269,42 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 37.649 lekë]; **(vii)** 28 – 30.11.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "turizëm, kemi qëndruar në hotel, ose hotel "{***}", ose hotel "{***}", Selanik, Greqi", dalje/hyrje nga pika kufitare Kapshticë me autoveturë, subjekti, bashkëshorti dhe dy djemtë, janë përllogaritur shpenzime në total për udhëtimin prej 57.669 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 50 eurosh/dita/ të rriturit x 2 veta x 2 ditë + 25 euro/dita/ fëmijë 5-18 vjeç x 2 veta x 2 ditë = total 300 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 112,68 eurosh [880 km vajtje Tiranë/ Kapshticë/ Selanik x 7 litra/ 100 km x 1,17986 euro/litër = 72,68 euro + 40 euro kartoni jeshil = 112,68 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi 412,68 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 57.669 lekë.]; **(viii)** 28-30.03.2015, të cilin e ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***} si: "vizitë te halla ime (nga familja biologjike) E. M. dhe kushëriri im K. Q., rezidentë në Kavala, Greqi, {***}, Kavala, Greqi", bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. {***}, ka deklaratë, datë 12.02.2019, nga z. K. Q., i cili deklaron se ka siguruar akomodimin dhe qëndrimin e familjes së subjektit në banesën e tyre, nuk ka specifikuar kohë pasi nuk e kujton, por shprehet se subjekti, znj. Anila Guri, dhe familja e saj kanë bërë vizita shumë të shpeshta. Sipas metodologjisë në Kolegj, janë konsideruar shpenzime qëndrimi 5 euro/ dita. Për udhëtimin, janë përllogaritur shpenzime prej 25.038 lekësh [përllogaritur shpenzime qëndrimi prej 5 euro/dita/ të rriturit x 4 veta x 2 ditë = 40 euro, total 40 euro; shpenzime udhëtimi me automjet, sipas raportit TIMS, i janë përllogaritur shpenzime prej 139,18 eurosh [1.106 km vajtje Tiranë/ Kapshticë/ Kavala x 7 litra/ 100 km x 1,281016 euro/litër = 99,18 euro + 40 euro kartoni jeshil = 139,18 euro; në total, së bashku me kosto qëndrimi, 179,18 euro x 139,74 kursi mesatar vjetor i këmbimit = 25.038 lekë]; **(ix)** 13-21.06.2015, djali K. G. ka shpjeguar në pyetësorin nr. {***}: "udhëtim për të*

**29.12.2.** Për sa më sipër, nga Kolegji, për vitin 2015, u kryen përllogaritjet përkatëse:

**a)** duke konsideruar efektet e rivlerësimit për “Shtesa/pakësime në likuiditet *cash* dhe në bankë”, të cilat vijnë si pasojë e pretendimit të rivlerësimit të likuiditeteve në valutë [trajtuar më sipër], duke e ndryshuar efektin e këtij zëri si pasojë e “rritjes” në total të likuiditeteve në bankë, si shtesë në shumën prej 710.269 lekësh, që, e krahasuar me Komisionin, rezulton 152.661 lekë më pak nga vlera 862.930 lekë, dhe me diferencë prej 5.881 lekësh nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit për “rivlerësim valute”, prej 158.542 lekësh;

**b)** duke rillogaritur “Shpenzimet e udhëtimit” sipas metodologjisë në Kolegj, të cilat rezultuan më të ulëta në krahasim me përllogaritjet e Komisionit, prej (-) 39.009 lekësh;

**c)** duke saktësuar “Të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave” sipas lëvizjeve të llogarive bankare që rezultojnë në vlerën prej 44.075 lekësh[79], që është më e madhe se sa vlera e llogaritur nga Komisioni, prej 42.434 lekësh, në shumën prej (+)1.640 lekësh, si dhe

**ç)** duke lënë elementet e tjera në analizë sipas Komisionit.

**29.12.3.** Për sa më sipër, trupit gjykues të Kolegjit, për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur i rezultuan me diferencë pozitive prej (+) 71.546 lekësh[80], në ndryshim nga vlera që i rezultoi Komisionit, me diferencë të pajustifikuar me burime të ligjshme, prej (–) 121.764 lekësh.

**29.13.** Në përmbyllje të kontrollit të analizës financiare për vitet 2006, 2009, 2011, 2012, 2014, 2015, të ankimuara nga subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga diferenca e pajustifikuar prej (–) 2.131.883 lekësh[81] që i ka rezultuar Komisionit, dhe ndryshe nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit në vlerën prej (–) 692.656 lekësh[82], trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kishin mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (–) 1.272.570 lekësh[83].

---

*shkëmbyer eksperiencat midis të rinjve të vendeve të ndryshme. Pension, Hindrichuv Hradec, Czech Republik, Ceki”, e sipas përgjigjeve në pyetësor dhe në përgjigje të rezultateve hetimore, subjekti ka shpjeguar se kostot për udhëtimin, akomodimin dhe ushqimin kanë qenë të mbuluara nga shoqëria organizuese, shoqata joqeveritare “{***}”, mbështetur nga Erasmus+, në kuadër të projektit “Rainbow”, projekt që synonte të krijonte një ambient inovativ, duke mbajtur në qendër nevojat e studentëve. Subjekti ka dorëzuar akte në Komision lidhur me këtë udhëtim, e në analizën në vijim, nuk janë llogaritur shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi.*

[79] *Si total i 18.675 lekëve të depozitës në lekë të subjektit në {***}; 153 eurove të depozitës në euro të subjektit të rivlerësimit në {***}; 34,21 USD të depozitës në USD të subjektit të rivlerësimit në {***}.*

[80] *Si rezultat i (a) të ardhurave në total prej 1.978.529 lekësh, rritur nga Komisioni prej +1.640 lekësh, si rezultat i saktësimit të interesave nga depozitat bakare, zbritur (b) shpenzime në total prej 1.196.714 lekësh, pakësuar nga Komisioni prej – 39.009 lekësh, si rezultat i përllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit, zbritur (c) pasuri në total prej 710.269 lekësh, ndryshim nga Komisioni referuar pretendimit për rivlerësimin e likuiditeteve në monedha të huaja.*

[81] *Si total i rezultateve negative: në vitin 2006, prej – 434.268 lekësh; në vitin 2009, prej – 794.312 lekësh; në vitin 2011, prej – 233.568 lekësh; në vitin 2012, prej – 463.433 lekësh; në vitin 2014, prej – 84.538 lekësh; dhe në vitin 2015, prej – 121.764 lekë.*

[82] *Si total i rezultateve negative në tabelën në ankim, në faqen 38: në vitin 2006, prej – 86.877 lekësh; në vitin 2009, prej – 106.320 lekësh; në vitin 2011, prej – 189.560 lekësh; në vitin 2012, prej – 309.899 lekësh.*

[83] *Si total i rezultateve negative: në vitin 2006, duke u ulur në – 38.042 lekë; në vitin 2009, duke u ulur në – 707.226 lekë; në vitin 2011, duke u ulur në – 167.863 lekë; në vitin 2012, duke u ulur në – 359.439 lekë. Viti 2014 me rezultat pozitiv, + 53.734 lekë; dhe viti 2015, me rezultat pozitiv, + 71.546 lekë.*

**29.14.** Lidhur me analizën financiare për periudhën 2006 - 2016, trupi gjykues, bazuar në analizën financiare të kryer në Kolegj, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, vlerëson se bilanci negativ rezulton të jetë konsiderueshëm më i vogël se sa ai i konstatuar nga Komisioni. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, por bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo problematikë nuk mund të shërbejë për t'u kualifikuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**30.** Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

**31.** Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur në mënyrë kumulative, nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit, për pasojë ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**32.** Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 184, datë 19.07.2019, i Komisionit duhet ndryshuar, pasi ai nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte e ligj.

## PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me shumicë votash,

## VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, dhe konfirmimin e saj në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm

U shpall sot, më datë 10.06.2022, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi - kundër*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

**1.** Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 19, datë 10.06.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. 184, datë 19.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, dhe konfirmimi i saj në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**2.** Në gjykimin tim, vendimi i marrë nga shumica e trupit gjykues, është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën, Aneksin e saj, ligjin nr. 84/2016, si dhe faktet e provat e administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje. Kam shprehur fillimisht mendimin tim kundër vendimit të shumicës, sa i përket vendimit të ndërmjetëm për kalimin për shqyrtim të çështjes në seancë gjyqësore publike, si dhe zgjidhjes në themel të kësaj çështjeje.

**3.** *Lidhur me formën e shqyrtimit të kësaj çështjeje në Kolegj*, në seancën gjyqësore në dhomë këshillimi më datë 11.05.2022, jam shprehur kundër vendimit të ndërmjetëm të shumicës së trupit gjykues për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim konstatimin e drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike të çështjes në bazë të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar. Qëndrimi im kundër mbështetet në faktin se aktet shkresore në dosje, flisnin qartë dhe bindshëm dhe ishin më se të mjaftueshme për të arritur në një vendimmarrje të bazuar në prova dhe në ligj, pa qenë nevoja e zhvillimit të debatit gjyqësor, që në vlerësimin tim, rezultoi thjesht një hap procedural i panevojshëm, joproduktiv dhe aspak në favor të ekonomisë gjyqësore. Këtë qëndrim kundër e përforcon fakti se nuk u konstatua asnjë shkelje e rëndë procedurale gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, si dhe refuzimi i marrjes në cilësinë e provave të reja, të akteve shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, e bëjnë edhe më të panevojshëm kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Në gjykimin tim, seanca gjyqësore publike rezultoi më shumë formale sesa produktive për vendimmarrjen në kushtet kur parashtrimet e subjektit nuk u shoqëruan me dokumentacion provues ligjor.

**4.** *Lidhur me themelin e çështjes*, kundërshtimi që i bëj vendimit të shumicës, qëndron në katër arsye kryesore, të cilat i konsideroj të një rëndësie thelbësore në vlerësimin e kriterit të pasurisë: *i) pasaktësia në deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë periodikë dhe në deklaratën e pasurisë vetting të subjektit të rivlerësimit, sa i përket çmimit të banesës të ndodhur në rrugën "{***}", Tiranë, burimit të krijimit të pasurisë dhe pjesës takuese të subjektit; ii) posedimi i kësaj banese për një periudhë 22- vjeçare; iii) problematika e konstatuar në çmimin e pasurisë "tokë truall"; si dhe iv) zbatimi i gabuar nga shumica e trupit gjykues i parimit të proporcionalitetit*.

**4.1.** *Pasaktësia në deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë periodikë dhe në deklaratën e pasurisë vetting të subjektit të rivlerësimit, sa i përket çmimit të banesës të ndodhur në rrugën "{***}", Tiranë, burimit të krijimit të pasurisë dhe pjesës takuese të subjektit:*

**4.1.1.** Nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, rezulton:

**a)** *Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, 2003*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *banesë dy kate, plus papafingo, vlera 7.000.000 (shtatë milionë) lekë, pjesa takuese 50%, rruga "{***}"*. Si burim krijimi, ka deklaruar: *[...] të ardhura nga shitja e një banese në Gjirokatër dhe të ardhurat familjare*.

**b)** *Në deklaratën e pasurisë vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *banesë tri kate dhe një kat bodrum, me sipërfaqe ndërtimi 460 m$^2$, rruga "{***}", sot rruga "{***}", vlera e banesës 6.500.000 lekë, së bashku me mobilimin, pjesa takuese 50%*. Si burim krijimi, *të ardhurat e bashkëshortit të fituara nga aktiviteti i tij tregtar pas vitit 1990, puna pranë disa institucioneve dhe në mobilim ka kontribuar subjekti i rivlerësimit*.

**4.1.2.** *Lidhur me vlerën e kësaj pasurie*, në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, 2003, dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, në kuadër të kontrollit në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën *7.000.000 lekë*, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* në vitin 2017, këtë vlerë e deklaron *5.000.000 lekë*. Në përgjigjet e pyetësorit standard [protokolluar nr. {***}, datë 01.04.2019], subjekti i rivlerësimit shprehet: *Lidhur me vlerën e deklaruar të banesës, në "deklaratën vetting", vlera totale e deklaruar, përfshirë dhe mobilimin, është deklaruar rreth 6.500.000 lekë, pra është deklaruar së bashku me mobilimin që është rreth 1.500.000 lekë, dhe vlera e banesës është deklaruar 5.000.000 lekë.* Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, vetëm me konstatimin në deklarim në deklaratën e pasurisë *vetting*, të vlerës së banesës objekt shqyrtimi për 2.000.000 lekë më pak se vlera e deklaruar e saj në deklarimet e mëparshme 2003 e ILDKPI, shumica e trupit gjykues duhet ta kishte trajtuar këtë deklarim si tendencë të subjektit të rivlerësimit për të fshehur vlerën reale të pasurisë, me qëllim shmangien e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

**4.1.3.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezultojnë disa të dhëna të rëndësishme, të cilat provojnë që subjekti i rivlerësimit ka kontribuuar në krijimin e kësaj pasurie:

- *së pari, lidhur me pjesën takuese*, subjekti i rivlerësimit, në të gjitha deklarimet periodike dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar se *zotëron 50%* të kësaj pasurie, duke konfirmuar në këtë mënyrë bashkëpronësi mbi këtë pasuri;

- *së dyti, lidhur me burimin e krijimit*, në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, 2003, subjekti deklaron, ndër të tjera, *të ardhura nga shitja e një banese në Gjirokastër dhe të ardhura familjare, ndërsa* në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk rezulton t'i ketë deklaruar këto dy burime, të cilat do të implikonin subjektin e rivlerësimit në rast se do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare, e cila që do të çonte në mënyrë të pashmangshme në aplikim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, zbatimin e nenit 61, pika 3 e këtij ligji, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anila Guri;

- *së treti,* në deklaratën e pasurisë *vetting,* personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, deklaron: *të ardhura të fituara nga puna e bashkëshortes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për periudhën nga muaji shkurt 1994 e në vazhdim;*

- *së katërti,* në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *[...] në kryerjen e ndonjë punimi rifiniture në banesë, kam ndihmuar dhe unë nga pikëpamja ekonomike, kjo nga koha e fillimit të bashkëjetesës 2000, me të ardhurat që siguroja nga puna ime dhe ndonjë e ardhur në formë dhurate që m'u dha nga prindërit e mi biologjikë dhe nëna ime adoptive, por për blerjen e truallit, unë nuk kam asnjë kontribut [...].*

**4.1.4.** Për sa më sipër, arsyetimi i përdorur nga shumica se subjekti i rivlerësimit nuk ka kontribuuar në ndërtimin e kësaj shtëpie, rezulton *alogjik*, pasi vetëm nga analizimi i datave, të dokumenteve në dosje rezulton:
*i.* blerja e truallit, nëpërmjet kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., më 13 nëntor 1998;
*ii.* lindja e djalit të subjektit të rivlerësimit, më 07.09.2000;
*iii.* martesa e subjektit të rivlerësimit më 10.10.2000 dhe ndërtimi i kësaj banese në vitin 2000.
Në këto kushte, nuk mund të pretendohet se banesa trekatëshe është ndërtuar plotësisht në vitin 2000, dhe pa përfshirë kontributin e subjektit të rivlerësimit, që minimalisht ka nisur bashkëjetesën në vitin 1999, të paktën 9 muaj para lindjes së fëmijës, kur shtëpia ishte e papërfunduar. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, konkretisht: *[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën,* pasi nuk është treguar e sinqertë duke tentuar të shtrembërojë faktet me qëllim anashkalimin e kontributit të saj në krijimin e kësaj pasurie.

**4.2.** Përpos arsyeve më sipër, fakti që kjo pasuri është poseduar *de facto* për një periudhë shumë të gjatë kohore prej 22 vitesh, në mënyrë të vazhdueshme e të pandërprerë nga subjekti i rivlerësimit, e që në përfundim të procedurave të legalizimit, do të regjistrohet dhe në emër të saj, si dhe fakti që është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, vlerësoj se ndodhemi në kushtet tipike të parashikuara nga neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në <u>pronësi ose në përdorim</u> pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe <u>të personave të lidhur</u>.* Referuar kësaj dispozite kushtetuese, edhe nëse hipotetikisht do të pranonim pretendimet e subjektit, gjatë procesit të rivlerësimit se *nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme*, përsëri subjekti i rivlerësimit nuk përjashtohet nga detyrimi për të justifikuar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**4.2.1.** Sa u përket *të ardhurave të bashkëshortit të fituara nga aktiviteti i tij tregtar pas vitit 1990,* të cilat në deklaratën e pasurisë *vetting,* janë deklaruar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie,

konstatoj se këto "të ardhura nga aktiviteti tregtar me kambizëm në qytetet e Shkodrës, Durrësit dhe Tiranës, për periudhën 1990 – 1992; nga aktiviteti tregtar bar-kafe (disko) pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, objekt i marrë me qira; shitje automjetesh të përdorura në periudhën 1990 – 2000, në shuma: rreth 10.000.000 lekë" nuk përmbushnin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar të ligjshme, pasi për këto të ardhura, nuk u provua shlyerja e detyrimeve tatimore. Bashkëshorti i subjektit nuk figuron të ketë qenë i regjistruar në asnjë organ tatimor në Republikën e Shqipërisë për këtë periudhë.

**4.2.2.** Rezultatet e analizës financiare të kryer në Komision, për të verifikuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të personit të lidhur deri në fund të vitit 2002, përdorur për ndërtimin e banesës në rrugën "{***}", treguan mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën ***10.640.188 lekë*** [faqe 10 e vendimit të Komisionit].

**4.3.** *Për pasurinë "tokë truall",* çmoj se nuk duhet të ishte anashkaluar pa u vlerësuar nga shumica e trupit gjykues, blerja nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, më 13.11.1998, i një trualli me sipërfaqe 1500 $m^2$ [dy parcela 500 $m^2$ dhe 1000 $m^2$, përkatësisht] ndodhur në Tiranë, në vlerën 1.500.000 lekë, shitur nga kjo sipërfaqe vetëm katër ditë më pas, më 17.11.1998, 500 $m^2$ po në shumën 1.500.000 lekë, në të njëjtën vlerë me atë të blerjes së gjithë sipërfaqes 1500 $m^2$, që në vlerësimin tim, përbën një transaksion fiktiv e absurd, në kundërshtim të hapur me ligjin. Shumica e trupit gjykues nuk u ndal as ta diskutonte këtë fakt, edhe pse vetë subjekti i rivlerësimit shitjen e kësaj pasurie e ka deklaruar si *të ardhur* në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**4.4.** Në përfundim të sa trajtuar më sipër, e vlerësoj të gabuar arsyetimin e shumicës së trupit gjykues në vendim, se: *problematikat e konstatuara lidhur me pasurinë banesë në rr. "{***}", Tiranë, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale, të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit*. Në arsyetimin tim, duke mbajtur në konsideratë rrethanat konkrete të çështjes, të parashtruara në këtë mendim pakice, gjykoj se nuk mund të udhëhiqemi nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, në kushtet e një bilanci negativ burimesh të ligjshme, pamjaftueshmëri në krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 10.640.188 lekë. Bilanci negativ i konstatuar nga Komisioni, do të rritej nëse do të konsideronim shpenzime udhëtimi, qëndrimi, tarifa spitalore të subjektit të rivlerësimit në ShBA, për lindjen e djalit të dytë, të cilat vetë ajo e pyetur, ka deklaruar 0 (zero) dhe shumica e trupit gjykues gabimisht i pranoi të mirëqena, edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë bindëse se këto shpenzime janë paguar nga të tretë. Aplikimi i parimit të proporcionalitetit, nga shumica e trupit gjykues, është pasojë e një rezultati negativ, të përllogaritur në mënyrë të padrejtë, nëpërmjet reduktimit të problematikave të pasurive, prej gjenezës së krijimit të aseteve të subjektit të rivlerësimit, me logjikë të ftohtë dhe në kundërshtim të hapur me ligjin, duke e katandisur tërësinë e saj në diferencën minimale negative mbi të cilën është zbatuar gabimisht parimi i proporcionalitetit.

5. Për gjithë sa arsyetuar, çmoj se vendimi i marrë nga shumica e trupit gjykues, është në kundërshtim të plotë me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur mungesa e burimeve financiare për krijimin e pasurisë banesë me tri kate në rrugën "{***}", Tiranë, ka rezultuar mbi 10.000.000 lekë, bilanci negativ për periudhën 2006 – 2016 ka rezultuar (-) 1.272.570 lekë, pa konsideruar shpenzimet e lindjes së djalit në ShBA, e bëjnë të pabazuar zbatimin e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germat "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016, me pasojë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

6. Në përfundim, votova kundër shumicës për sa i përket mënyrës së arsyetimit dhe zgjidhjes përfundimtare të çështjes. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, si kusht i domosdoshëm për konfirmimin e saj në detyrë, duke kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë kriter.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, nuk isha dakord me zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni") dhe votova kundër shumicës, e cila konfirmoi subjektin në detyrë. Në përfundim të procesit të zhvilluar në Kolegj mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit, balanca negative e analizës financiare të konstatuar në Komision, u gjet në vlerën 1.272.570 lekë. Shumica konkludoi që, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo problematikë financiare nuk mund të shërbejë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit në drejtim të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2. Votova kundër shumicës pasi vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e *proporcionalitetit*. Në balancën negative të mësipërme, të përllogaritur në Kolegj, ndër të tjera, nuk përfshihet një shpenzim i konsiderueshëm – për të cilin subjekti ka dështuar të provojë financimin nga një person tjetër apo burimet e ligjshme të këtij të fundit – të cilat variojnë minimalisht nga 11 mijë USD në 15 mijë USD. Në këtë vlerësim, mbaj në konsideratë problematika të vendimmarrjes së Komisionit që bien ndesh me ligjin dhe krijojnë standard kontrolli të pasurive që favorizon përshkrime të pasurive nga subjektet që bien ndesh me deklarimet e tyre nën përgjegjësi dhe me faktet që rezultojnë nga aktet në fashikull.

3. Në vlerësimin tim, në përmbledhje edhe të këtyre aspekteve, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Për pasojë, vendimi i Komisionit për shkarkimin e saj duhej të ishte lënë në fuqi. Argumentet mbi të cilat bazohet sa më sipër, shtjellohen në vijim.

4. Komisioni ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, ka qenë kontradiktore në deklarimin e vlerës së ndërtimit të kësaj pasurie. Konkretisht, në deklaratën e pasurisë [*vetting*], subjekti ka deklaruar vlerën 6.500.000 lekë, së bashku me mobilimin dhe pjesë takuese: 50/50 me bashkëshortin. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të vitit 2003, subjekti ka deklaruar në funksion të kësaj pasurie, truall me sip. 1000 m², në vlerën 3.000.000 lekë dhe banesë 2 kate + papafingo, në vlerën 7.000.000 lekë. Në ILDKPKI, në vitin 2013, gjatë procedurës së kontrollit të ushtruar nga ky organ, subjekti ka deklaruar pasurinë po ashtu në vlerën 7.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, ka qenë kontradiktore edhe në lidhje me pjesën takuese, si dhe me burimet e krijimit. Konkretisht, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burime "të ardhurat e bashkëshortit të fituara nga aktiviteti i tij tregtar pas vitit 1990 dhe puna pranë disa institucioneve". Në pjesën e mobilimit, ka kontribuuar edhe subjekti. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim: trashëgimi dhe kursime të bashkëshortit, të ardhura nga shitja e një banese në Gjirokastër, si dhe të ardhura familjare. Sa u përket pjesëve takuese, në të dyja deklaratat, subjekti ka deklaruar pjesë takuese 50% të pronësisë.

5. Përpos pasaktësive, Komisioni ka konkluduar që, për sa i përket vlerës së ndërtimit, vlera referuese më e përafërt e ndërtimit të banesës, sipas deklarimit të pasurisë [*vetting*], sipas vlerave mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, do të ishte *11.398.800 lekë*[84]. Personi i lidhur ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave të përdorura për ndërtimin e banesës, në shumën *10.640.188 lekë*. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar që, edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit të

---

[84] *Faqe 8 e vendimit të Komisionit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 362/2000: https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Anila-Guri.pdf.*

rivlerësimit, duke e konsideruar (koston e ndërtimit) në shumën prej 5.400.000 lekësh[85], gjithsesi do të konstatohej një mungesë e burimeve financiare të ligjshme prej rreth *4.640.000 lekësh*, për krijimin e kësaj pasurie. Pavarësisht se subjekti ka përfshirë edhe kontribut nga ana e saj në mobilim, si dhe të ardhura nga shitja e banesës prindërore në Gjirokastër si burim, në deklaratën fillestare, Komisioni theksoi se nuk rezultoi e provuar se subjekti ka kontribuuar në ndërtimin e banesës para momentit të lidhjes së martesës. Së fundmi, fakti që banesa deklarohet në pjesë të barabarta me bashkëshortin, sipas Komisionit përbën deklarim të pasaktë.

**6.** Në ankim dhe në prapësimet e saj në seancën publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendon se pasuria është krijuar e gjitha nga investime të bashkëshortit, përpara martesës së tyre. Subjekti dhe bashkëshorti kanë lidhur martesë në gusht 2000 dhe fëmija i parë u ka lindur në shtator 2000. Shumica i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe vlerësoi se, ndonëse ajo ka deklaruar kontribut në mobilimin e shtëpisë dhe pavarësisht nga fakti që lidhja e saj me bashkëshortin përpara martesës ligjore është faktuar, të konsiderohet si moment bashkimi në ekonominë familjare gushti 2000.

**7.** Në vlerësimin tim, pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt analize, duhet të ishte pjesë e vlerësimit të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit pasi, së pari, pasuritë e krijuara përpara martese nga personat e lidhur, jo domosdoshmërisht përjashtohen nga kontrolli në parim. Nën dritën e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, kontrollit të pasurisë i nënshtrohet pasuria e subjekteve dhe e personave të lidhur me ta. Në këto kushte, edhe gjatë praktikës së tyre, institucionet e rivlerësimit kanë kontrolluar pasuri të krijuara përpara martese, duke pasur në vëmendje aspekte, si fakti që subjekti gëzon frytet e atyre pasurive, siç dëshmohet edhe nga jurisprudenca e Kolegjit në disa çështje[86].

**8.** Së dyti, përpos faktit që subjekti gëzon frytet e kësaj pasurie, nga analiza e akteve në fashikull, rezulton që pasuria objekt analize nuk është krijuar krejtësisht përpara martese. Ky vlerësim mbështetet në faktet që vijojnë.

- Ndërtimi ka filluar në vitin 1998, por rezulton të ketë vazhduar më pas[87]. Konkluzioni i Komisionit për mosprovim të kontributeve prej subjektit në këtë investim, bazohet mbi alogjizëm edhe për sa kohë referon faktin që kontributi kushtëzohet nga fakti që “kjo banesë ende nuk është e regjistruar, nuk ka një akt juridik që të përcaktojë pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit, me qëllim analizën e tyre”. Në kushtet kur Komisioni ka kryer një vlerësim të vetin për koston, bazuar në çmimet mesatare të referuara nga EKB-ja, dhe nga ana tjetër ka një vlerësim të kryer nga vetë subjekti për koston e kësaj pasurie, ky konkluzion është i pakuptimtë.
- Rezulton që trualli është blerë në nëntor 1998. Vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, në deklarimet e saj referon veçmas momentet kohore dhe investimin e kryer për blerjen e truallit për shtëpinë. Në të njëjtën linjë, ajo ka kryer edhe deklarimin për pjesën takuese të bashkëshortit për truallin [100%] përkundër shtëpisë – deklaruar 50% në pronësi të saj.
- Ky deklarim – në pjesë të barabarta mes saj dhe bashkëshortit – pasqyrohet në deklaratën periodike vjetore për herë të parë, në vitin 2003, sikurse edhe në deklaratën e pasurisë. Në kushtet kur subjekti

[85] *Sipas vlerës së parashtruar nga eksperti i kontraktuar nga subjekti.*
[86] *Shih vendimet e Kolegjit për subjektin e rivlerësimit A. Liçaj nr. 23/2019 [JR], K. Selita nr. 15/2021 [JR] dhe A. Sevdari nr. 6/2019 [JR], në: https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/12/Vendimi-A-Licaj-i-anonimizuar.pdf, https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi_Kastriot_Selita_web-2.pdf.*
*Dhe: https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-A.-Sevdari-i-anonimizuar-per-publikim.pdf.*
[87] *Shih faqen 7 të vendimit të Komisionit, paragrafi VII, pa numër.*

dhe bashkëshorti nuk duket se kanë zgjedhur regjimin martesor të pasurive të ndara, deklarimi i pasurisë në pjesë të barabarta, tregon që subjekti dhe bashkëshorti e konsiderojnë pasurinë të krijuar gjatë martesës.

- Fakti që ka vijuar ndërtimi, rezulton edhe nëse krahasohen deklarimet e kryera nga subjekti ndër vite. Konkretisht: në deklaratën periodike vjetore për vitin 2003, subjekti e deklaron ndërtesën me tri (3) kate; në deklaratën e pasurisë *vetting,* deklarohet të jetë me katër (4) kate.
- Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, të ardhurat "nga shitja e pasurisë në Gjirokastër". Qartazi, ky deklarim referon pasurinë e familjes së origjinës së subjektit – apartament në Gjirokastër – shitur në vitin 1996[88]. Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit nuk rezulton të ketë pasur apartament të privatizuar në Gjirokastër.

**9.** Pavarësisht nga sa më sipër, duke e trajtuar pasurinë si përgjegjësi të personit të lidhur, në analizën financiare, Komisioni nuk rezulton të ketë lidhur asnjë pjesë të mungesës së burimeve të ligjshme që rezultuan prej hetimit administrativ, me subjektin e rivlerësimit, duke e bërë të pakuptimtë arsyetimin e tij nga faqja 5 deri në faqen 12 të vendimit. Konkretisht, Komisioni konstaton që nuk ka rezultuar e provuar "se subjekti ka kontribuuar në ndërtimin e saj para momentit të lidhjes së martesës[89]", pa analizuar çfarë pasoje ka kjo gjetje në raport me vlerën financiare që prezumohet se duhet të ketë kontribuuar subjekti pas martese, çfarë passjell kjo mungesë burimesh në kontekstin e procesit të rivlerësimit të subjektit dhe për çfarë qëllimi konstatohet një mungesë burimesh që i atribuohet vetëm personit të lidhur, për një pasuri që nënshtrohet kontrollit për shkak të rivlerësimit të vetë subjektit.

**10.** Në kushtet kur Komisioni kishte një interpretim ligjor i cili në thelb përjashtoi çdo përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit, meqenëse mungesa e burimeve [në vlerën *10.640.188 lekë*] i atribuohej e gjitha personit të lidhur, hetimi administrativ i kryer nga Komisioni dhe analiza për mundësitë e krijimit të pasurisë me burime të ligjshme, reduktohet në një konstatim që mund të përmblidhej edhe në një poshtëshënim, si koment kalimtar. Këtë vlerësim e mbështes edhe në faktin që gjatë procesit, nuk rezulton që subjekti të jetë pyetur nga Komisioni e as të ketë parashtruar dokumente për të provuar qartë sa ishte kontributi i bashkëshortit përkundër kontributit të saj. Në përgjigjet e saj në Kolegj, sërish subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, nuk parashtroi akte dhe fakte, të cilat minimalisht duhet të ishin parë në drejtim të përpjekjes për të mos qenë transparente dhe e sinqertë.

**11.** Komisioni gjeti mungesa burimesh për krijimin e një pasurie në vitin 2010, dhe nga analiza financiare e viteve 2006-2016, konstatoi një balancë negative për gjashtë nga këto vite, në vlerën 2.131.883 lekë[90]. Në këtë analizë, Komisioni nuk përfshiu dhe as i dha një qëndrim me relevancë në procesin e rivlerësimit gjetjeve të veta për mungesë burimesh dhe deklarim të paplotë nga subjekti për shpenzimet e kryera për qëndrimin spitalor dhe kujdesin mjekësor në ShBA në vitin 2006, për lindjen e djalit të saj të dytë, duke zgjedhur t'i konsiderojë shpenzimet pa asnjë vlerë. Ky vlerësim nuk bazohet në "një provë mbi moskryerjen e shpenzimeve nga subjekti" dhe në mungesë të kësaj prove, në një proces ku barrën e provës e ka subjekti – Komisioni elaboron gjerësisht në faqet 20 dhe 21 të vendimit:

---

[88] *Referuar edhe në funksion të krijimit të një pasurie në Velipojë, me të ardhurat e nënës nga shitja e këtij apartamenti. Faqe 14, pika 4 e vendimit të Komisionit.*
[89] *Faqe 9 e vendimit të Komisionit.*
[90] *Sipas arsyetimit të pasqyruar në vendimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet dhe shtesën në kursime në vitet 2006, 2009, 2011, 2012, 2014 dhe 2015.*

*[…] Kjo situatë rrodhi për shkak të mosaktivizimit në kohën dhe mënyrën e duhur të subjektit për të provuar bindshëm, së pari, shumën e paguar për shërbimet spitalore dhe, së dyti, burimin financiar që kishte mundësuar pagesat e kryera. Në këto kushte, për vitin 2006, Komisioni përllogariti vetëm shpenzimet e udhëtimit në ShBA dhe ndonëse konstatohet të qe në kushtet e mungesës së burimeve[91] dhe deklarimit të paplotë pasi nuk provoi: (i) shumën që lidhej me detyrimet financiare për shërbimet spitalore në fjalë; (ii) personin që ka përballuar këto shpenzime; (iii) burimin financiar që kishte mundësuar pagesat e shërbimeve spitalore, shpenzimet iu konsideruan në vlerën zero (0 lekë).*

**12.** Me fjalë të tjera, mospërmbushja aktive e detyrimit kushtetues që rrjedh nga barra e provës, rezultoi ta favorizojë situatën financiare të subjektit, duke krijuar një situatë favorizuese për subjektin, për sa kohë mospërmbushja e detyrimeve kryhet në mënyrë konsekuente. Komisioni zgjodhi të zerojë shpenzimin meqenëse subjekti dështoi të përmbushte detyrimet në funksion të procesit të kontrollit të pasurisë.

**13.** Së dyti, nga një hulumtim sipërfaqësor në burime të hapura, rezulton se shpenzimet mjekësore që shoqërojnë procedura të thjeshta lindjeje në ShBA, variojnë nga vlera 11 mijë USD në 15 mijë USD[92]. Kërkimet e thjeshta gjenerojnë raporte të shumëllojshme, disa prej të cilave të publikuara nga burime zyrtare të qeverisë së ShBA-së[93], përpos atyre të publikuara nga autorë dhe entitete të ndryshme jopublike. Në këto kushte, konkluzioni i sipërcituar i Komisionit për mungesë informacioni për shpenzimet, duket i pakuptimtë dhe i pabazuar. Nga ana tjetër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në Kolegj për rrethanat familjare që kanë qenë shtysë e sponsorizimit, duke mos u shoqëruar me asnjë dokumentacion, nuk arritën ta shërojnë këtë mospërmbushje të detyrimit. Siç ka konstatuar edhe Komisioni, subjekti kishte kohë të mjaftueshme për të ndërmarrë hapa dhe mbledhur dokumentacion provues që në vitin 2017, teksa ka sjellë vetëm një deklaratë të thjeshtë nga i afërmi i bashkëshortit, i cili deklarohet si sponsorizues[94].

**14.** Në përmbledhje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, nuk ka depozituar informacion të detajuar dhe në formën e duhur ligjore për sasinë e shpenzimeve të kryera, mënyrën e pagesës [nëse njëherësh apo në disa këste], apo shpjegime bindëse e të mbështetura në dokumentacion për pretendimet e saj për mungesë gjurmësh të lëna nga pagesat. Pretendohet të pranohet një mënyrë kryerje transaksioni në vlera të konsiderueshme i cili nuk ka lënë asnjë gjurmë, ndërkohë që në të janë përfshirë institucione të cilat ushtrojnë aktivitet në një ekonomi ku veprimet me para në dorë [*cash*] përbëjnë përjashtim nga rregulli. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë ndërmarrë asnjë hap për të paraqitur dokumentacion për të provuar qëndrimin pa shpenzime, shpenzimet e mbuluara nga pritësi, apo mundësinë e këtij të fundit për të financuar qëndrimin dhe kujdesin mjekësor me burime të ligjshme, qoftë edhe për të provuar pamundësinë objektive, nën dritën e përcaktimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Nëpërmjet këtyre zgjedhjeve, subjekti i rivlerësimit ka pamundësuar kryerjen e hetimit dhe kontrollit të kriterit të pasurisë. Të gjitha këto detaje me rëndësi, janë anashkaluar nga Komisioni për këtë subjekt rivlerësimi.

---

[91] *Balanca negative e vitit rezultoi në vlerën 434.268 lekë.*

[92]*https://www.businessinsider.com/how-much-does-it-cost-to-have-a-baby-2018-4*.

[93] *https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK555484/*.

[94] *Faqe 21 e vendimit të Komisionit.*

**15.** Për gjithë sa më sipër, vlerësoj se subjekti gjendej minimalisht në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për të, nuk duhet të kishte gjetur zbatim parimi i proporcionalitetit.

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*